

[II. Horologion – ώρολόγιον]

[f. 2] Nis o dora im' e mira e shkrua shkronja të mira, se mos rrihesh!²⁶

[f. 3] O mbreti i qiellit; e shifaetime Frymë e vërtetë, qi jetë do përpara e të gjitha i mbush! O hazine e të miravet qi jetë ep! Hajde e qindro edhe mbë ne e qirona neve nga çdo e ligë e na shpito o i dashur shpirtëret tanë! Shenti Perëndi, shenti i fortë, shenti i pavdekur; ndiena neve! Qoftë lavduria mbë Prindë edhe mbë Birë edhe mbë të Shintëruamenë Frymë; njëment edhe kurdo, edhe jetë pas jete të pasosurë kurrë! Ashtu qoftë!

[f. 4] E shëntëruara Triadha! Ndiene neve, Zot! Dhimsu mbë gjynahetë tona, Zot! Ndiene të paudhmetë tona – i Shëntëruarë! –, që na kujdes, e shirona hastallëqetë tona! Për emërit tat, Zot ndiene; Zot ndiene; Zot ndiene!

Ati ynë qi je mbë qiell:

U shëntëroftë emëri yt;

arthtë mbretëria jote;

u bëftë të dashuritë tat,

si mbë qiell edhe mbë dhe;

bukënë tënë të përdismen epnae neve sot;

e lena neve fajetë tona,

sikundrë edhe ne ndiemë borxhilitë tanë;

e mo na lerë të biemë na ndë piraksillëk;

po shpëtona neve nga çdo e ligë.

Ashtu qoftë!

[f. 5] Eni t'i falemi mbretit tënë, Perëndisë! Eni t'i falemi edhe t'i biemë Zotit Hrist, mbretit tënë, Perëndisë! Eni t'i falemi edhe t'i biemë metani mbë atë Zotnë Hrist, mbretinë edhe Perëndinë tënë! Lavduro o shpirti im Zotnë! Zoti Perëndi! – i madh je teprë.

26 Për përkthimet shqip të IMQ të 5 kronikave beratase, që ndodhen në këtë faqe shih më poshtë: [III. Kronika beratase]

Teksti i normalizuar shqip

Ashiqare lavdurinë edhe të math të gjarë e ke mveshur. Ke vënë mbë vete dritën e madhe. Si një rrobe e ndeve qiellë, si një lëkurë; e e çatise mbi ujrata të përsipërmet e tia që ve mbë ret të shkuarit tënt, e e çan me krahët të erëravet; [f. 6] që ke bëre angjet e tu frymëra, e husmeqarët e tu flakë prej zjari; qi themelose dhenë mbë të palajthitur e nukë luan nga vendi jetë pas jete. Yjet shumë si rrobe i rri përçark dheut. E barabar me malet qindrojnë ujrata, e nga urdhërata jote kanë frikë; edhe nga zëri yt i gjimuashmi leqendisen, ngrihen përpjetë si male e përsëri zbresën e bënen fusha. Mb'atë vënt të u vërë themeli atyre. Urdhratë u vure që nuk e shkcjnë, as nukë kthenen të mbulojnë dhenë qi urdhron e dalën burime nga bokërimet. E ndëpërmest të malevet shkojnë ujrata [f. 7] e vaditen gjithë ezhdahatë e pyjevet e begenisin shifaet egërsirat mbë etësi të tyre mbë ato ujra. Zoqtë të qiellit bëjnë konak e ndëpërmest të shkëmbënjëvet apnë zënë. E vadite malet që përsipër dheut e nga hushur e punëravet së tua shëmbet dheu e del bar për shtësët edhe njomështirë për punë të njëjëzevet. E nxjerr shiu bukë nga dheu edhe verë që e shëmp zemërën e njëriut që të ndritonet faqea me vaj edhe buka që zemërën e njëriut e forcon. E shëmben drutë e fushavet edhe dëllënja e livanit qi i ndërrove për punë.

[f. 8] Atje zoqtë bëjnë fole e erodhjajt. Konaku i ti i shkon ata malet e lart për drërët e shkëmbënjtë ardëm për lepurit. Bëri hënëzën për të diftyerë kohëtë e dielli, po që ashiqareps të perënduarit e ti, vë errëcirë e bënet natë. Mbë atë natë dalënë gjithë ezhdahatë e pyjeve, aslanëtë tuke ulëritur që të rrëmbejnë e të kërkojnë nga Perëndia zahire për vet'he. Po që lint dielli mblidhen e ndëpër strofkët të tyre tuliten e del njëriut pa frikë mbë punët të ti e punon mbë punët të ti gjer më darkë. Vërtet janë të mbëdha punërat e tua, o Zot! Të gjitha me shumë të ditur i bëre.

[f. 9] U mbush dheu nga të ngrehurat e tua e ky deti kaq i madhi dhe kaq i gjëri. Atje janë pishq që s'kanë numur, shtësë të vogëla me të mëdha. Atje gjemitë reshperojnë edhe ezhdahanë e madhe q'e gatove të lozë ndëpër të. Të gjitha nga ti presënë t'u apësh ushqimnë e tyre më çdo kohë. Po që u ep atyre mbledhënë e po që të hapësh dorënë të gjitha mbushen me të mira. E po të kthenç faqen tënde prej suresh, prishen,

Kreu IV

edhe po t' u heqësh frymën e tyre, shuhen mbë pluhuri' të tyre, kthenen, e po të dërgonç frymën tënde mbë ta, ndërtonen e e përtërin faqen e dheut.

[f. 10] Qoftë lavduria mbë Zotnë, jetë pas jete! E të gëzonet Zoti nga punërat e tia që vështron mbë dhe e e bën atë që dridhet; qi zë malet e tymosen nga zjari i ti. Ta lavduronj Zotnë mbë jetë time! Ta lavduronj Perëndinë, gjer sa të jem, që të begeniset mbë të fjala ime edhe unë të gëzohem mbë Zotnë. Le të shuhen gjynahqarët nga dheu edhe të paudhmit. Qi të mos jenë ata, lavduro – o shpirti im! – Zotnë, se dielli, po që ashiqareps të perënduarit e ti, vë errëcirë e bënet natë.

[Qoftë lavduria mbë atnë edhe mbë birë, edhe mbë të shëntëruamen frymë edhe njëmënt, edhe kurdo, edhe jetë pas jete të pasosurë kurrë! Ashtu qoftë!

Lavduronj Zotnë, lavduronj Zotnë, lavduronj Zotnë! Qoftë lavduria mbë ty o Perëndi! Lavduronj Zotnë, lavduronj Zotnë, lavduronj Zotnë! Qoftë lavduria mbë ty Perëndi! Lavduronj Zotnë, lavduronj Zotnë, lavduronj Zotnë! Qoftë lavduria mbë ty! – Perëndia shpresë!]

[f. 11] Qoftë lavduria mbë të lartit Perëndi edhe mbë dhe huzur mbë njerëzit të dashur! O Zot! – buzët e mia hapi e goja ime të ashiqarepsin lavdurinë tënde tre herë. O Zot! – qysh u shumuanë mbë mua mundimet e shumë hasme u ngritnë mbë mua. Shumë i thonë shpirtit tim më s'është leftheri mbë të nga Perëndi i ti. Ema ti – o Zot, ndihma ime! – je lavduria e ma lartëson kryetë tim. Me zë mbë Zotnë thirra e më dëgjoji qi nga urdhratë e shëntëruarë e tia. Ema unë po flinjam. Edhe pse fjeta, përsëri u ngricë se Zoti më dha ndihmë e më s'kam frikë nga milun halle qi përqark më janë mbledhur.

[f. 12] Ngrihu – o Zot! – e shpëtomë – o Perëndiu im! – se ti i përndave gjithë hasmit e mi që më lëftonin kot. Dhëmbët e gjynahqarëvet i dërmovë. Nga Zoti është leftheria e mbë hallkun tënt qoftë bekimi, o Zot!

O Zot! – mo me të zëmëruarë më qërto, as me gazepët tënt mos më mundo! Se shigjetat e tua u ngulë mbë mua, qi e forcove mbë mua dorën tënde e më s'është hilaç mbë trupt tim nga faq' e gazepit tënt. Më s'është huzur ndë kokalet e mia, nga faq' e gjynahevet së mia, se të paudhmet e mia e shkuanë kryetë tim e si barrë e rëndë u rënduanë mbë mua, u

Teksti i normalizuar shqip

qelbnë së kalburi plagët e mia. [f. 13] Nga faq' e marrëzisë sime u hallësuashë edhe u unjë gjer me të bitisur gjithë ditënë. I shëmtuarë ecnjam, se hiset e mia u mbushnë me dhunëra e më s' ishtë hilaç ndë trupt tim. U keqësuashë e u bindësuashë ngjer teprë e ulërinj me të shartuarit të zëmëresë sime. O Zot! – përpara teje gjithë oreksi im e shartima ime nga ti nuk u mshef. Zëmëra ime luajti edhe më la fuqia ime edhe ajo dritë e syve' t' mi, as ajo më s'ishtë me mua. Miqtë e mi e fqinjët e mija karshi meje u afruanë e qindruanë; e ata të afrit e mi që së largu ndejnë. [f. 14] E po nxitonin ata qi kërkonin shpirtinë tim; e ata që kërkonin të këqiat e mia, folë kot edhe hile, gjithë ditën për mua mendonin. Ama unë posi i shurdhrë nuk e dëgjonja edhe si nemec nuk e hapa gojnë time, po u bëshë si një njeri qi s'digjon edhe nukë ka ndë gojt të ti. Se unë mbë ty – o Zot! – shpreva. E ti më dëgjo, o Zoti Perëndi, se thashë të mos gëzohen mbë mua hasmit e mi; se unë po që luajta këmbën, mbë mua u mburrë. Se unë për të rrahur ishnjam hazër. Anxhak plaga ime përpara teje ishtë ashiqare. Se të paudhmen time unë e ashiqareps [f. 15] edhe çalstis për gjynahet e mia. Ema hasmit e mi rrocjnë edhe po fërconen mbë mua e teprë u shumuanë ata qi më mërzitën pa faji edhe ata qi më dhanë të këqia nga të mirat më kallëzuanë, pse ndiqnja të mirën. Mos më lërë ndë të keqe, o Zoti Perëndi! As mos u hiq nga unë, po shiko edhe mbë ndihmë time, se ti – Zot! – je lëtheria ime.

O Perëndi, Perëndia ime! Mbë ty shpejtonj, se u etësua shpirti im bashkë me trup' tim ndë dhe të shkretë, të pashkuarë edhe të papasur ujë. Kështu edhe mbë të shentëtuarën faqen u ashiqarepsë, qi të shof fuqinë tënde edhe lavdurinë tënde se fort e mirë ishtë ndiesa jote. [f. 16] Më teprë se kjo jetë, buzët e mia ty të mburrejnë. Kështu të lavduronj mbë jetë time edhe mbë emërit tat ngre duartë e mia. Posi me zahire të mira e të pira u shëmp shpirti im e me buzë të ngazëluame të lavduron goja ime. Ama unë pse të kujtonj ndë të shtruarit tim anxhak ndë mëngjes, më mirë flas me ty, se ti – o Zot! – u bëre ndihmë mbë mua edhe unë mbë mbulesët të krahëvet së tu ngazëlonem. U ngjit shpirti im pas teje e mua më ndih e djathta jote. Ata hasmit po nkot e kërkcnjë shpirtin tim, se do të hyjnë ndë të poshtrat e dheut edhe do t'epen ndë duar të shpatësë e hise e dhelpravet do të bënen. Pandaj mbreti gëzonet

Kreu IV

[f. 17] mbë Perëndinë e mburrënet. Kushdo përgjëronet mbë të, se thuret goja qi flet të këqia.

O Zoti Perëndi i leftherisë sime! Ditën thirra, edhe natën përpara teje. Le të vinjë përpara teje të luturit tim, [të] unjë vesnë mbë rixhat time, se u mbush me të këqia shpirti im, e jeta ime xhehnemit iu afrua e u nëmëruashë me ata qi zbresën ndë gropë e u bëshë si njeriu i pandimë edhe me të vdekurit, i leftherosur edhe si të plagosurit qi flenë ndë vart e emërat e tyre më s'ua kujton, se ata nga dora jote u dëbuanë. Ashtu më vunë dhe mua ndë gropë të thellë, të errtuashme edhe mbë hiet të vdekjes. [f. 18] E mbë mua u forcua zemërata jote e gjithë gazepet e tu i prure mbë mua. I largove të njohturit e mi nga unë e më bëre të mërëzitur. Mbë vet'het të tyre u dhashë mbë ta e më s'kam të shpëtuarë. E sytë e mi u verbuanë. Nga hallet thirra mbë ty – o Zot! – gjithë ditënë. E unë i ngrita mbë ty duartë. Mo se ndë të vdekurit bën thakmë, a mos heqimët i ngrënë që të ksomollojisen mbë ty, a mos munt të diftenjë ndonjë ndë varrt ndiesën tënde edhe të vërtetënë tënde ndë humbështirë, a mos mundë të njihen ndë errëcirë thakmat e tua e e vërteta jote ndë dhe të prishur. Unë mbë ty – o Zot! – thirra [f. 19] e ndë mëngjes të luturit tim arthtë te ti! Pse – o Zot! – më dëbon shpirtinë tim edhe e këthen faqen tënde nga unë? I varfër jam unë e me zahmete që më të ritë tim u lartësuashë, përsi u bindësuashë edhe u prishçë. Mbë mua erdhë gazepet e tua e frikët e tua më luajtën. U pëqarkësuanë hasmit posi ujrat e shumë. Gjith ditënë brenda më kishin kyçitur e nga fajet e mia i largove nga unë miknë edhe fqinjën, edhe ata të njohturit e mi nga hallet e mia.

Lavduro o shpirti im Zotnë edhe gjith të brendëmet e mia, emërin e shintëruarë të ti! Lavduro o shpirti im Zotnë [f. 20] e mos haro gjithë të dhënat e tia; atë që ndien gjith të paudhmet e tua e të shiron gjithë sëmundëtë; atë qi të shpiton nga e liga jetën tënde e të stefanos me ndiesë edhe me të dhimsura e ta mbush me shumë të mira oreksin tënt. E përtërihet si shqiponjës të ritë tënt. Bën ndiesë Zoti e gjyqe të drejta mbë gjith të varfërit. E ashiqarepsi udhët e tia Mojsiut edhe të Bijvet' Israilit të dashurat e tia. I dhimsur edhe i ndiesmë Zoti, i pazemëruarë edhe shumë i ndiesmë e jo ngjer tej zemërohet, [f. 21] as gjer më të sosur i kujton; i ashiqareps e jo pas të paudhmet tona na bëri neve, as pas

Teksti i normalizuar shqip

gjynahevet tona na dha neve. Se qi përsipër qiellit nga dheu e forcoi zoti ndiesën e ti mbë ata që kanë frikë mbë të. Sikundrë largojnë të lindurat nga të perënduarit, ashtu i ka larguarë nga ne të paudhmet tona. Sikundrë dhimset ati mbë bijt, ashtu dhimset Zoti mbë ata që kanë frikë mbë të, se ay e njeh gatimnë tënë, e ku[j]tonet se baltë jemi. Njeriu posi bari e [f. 22] ditët e tia e si lulet e aravet, ashtu fishket, se frymë ishtë ardhur mbë të e do të mos jetë, as të mos njihet më vënd' i ti. Ema ndiesë e Zotit nga kjo jetë e gjer m'atë jetë mbë ata qi kanë frikë mbë të e drejt' e ti, e bij pa[s] bijsh mbë ata qi ruanë fjalën e ti e kujtojnë porosit' e tia, të bëjnë ato. Zoti mbë qiell e ka hazër thronë e ti e mbretëria e ti të gjitha i urdhron.

Lavduronie Zotnë, gjith angjelit [f. 23] e ti, të fortët, të fuqishmit qi bëni fjalën e ti edhe e digjoni zënë e fjalëve' tia! Lavduronie Zotnë, gjith fuqit e tia, huzmeqarët e ti qi bëni të dashurat e tia! Lavduronie Zotnë, gjith punërat e tia më çdo vent të hyqmit të ti! Lavduro – o shpirti im! – Zotnë!

O Zot, digjoma të luturit tim! Merre vesht rixhanë time me të vërtetët tënde e dëgjomë me të drejtët tënde! [f. 24] As mos hajde mbë gjyq me robnë tënt, se nuk drejtësohet përpara teje çdo njeri qi rron. Se po ma ndjek dushmani shpirtin tim, e unji mbë dhe jetën time e më vu të rri ndë errcirë si të vdekuritë e moçim. E u bë i përtuashmë mbë mua fryma ime e mbë mua lua[j]ti zemëra ime, kur kujtova ditët e moçme e fola mbë gjith punërat e tua e mbë gjith punërat e duarvet së tua fola. Ngrita mbë ty duart e mia. [f. 25] Ema shpirti im si dheu i papasur vlak. Shpejt më dëgjo, o Zot, se më la fryma ime. E mos e kthe faqen tënde nga unë, qi të gjan si ata që zbresën ndë gropë të dëgjuashme e bën mbë mua mëgjesnet ndiesën tënde, se unë mbë ty shpreva. E ashiqarepsmë – o Zot! – udhën e mirë qi të ecinj, se unë mbë ty e ngrita shpirtin tim. Shpitomë nga dushmanët. Zot, mbë ty jam ardhur e mësomë qi të bënj të dashurat e tua, se ti je Perëndia im e Fryma jote e mira [më shpuftë] mbë udhë edhe mbë dhe të drejtë!

[f. 26] Për emërit tënt, o Zot, bëmë të ruashmë e me të drejtët tënde nxirre nga pocaqitë shpirtin tim e me ndiesët tënde shpori dushmanët

Kreu IV

edhe humbi gjithë ata qi e mundojnë shpirtin tim, se unë robi yt jam. Amin!

Mëme e Perëndisë, e virgjira, gëzohu o e gëzuashme Marinë, se Zoti me ty. E bekuarë je ti ndë mes' të gravet e i bekuarë hyshyr' i barkut tënt, se shpëtim linde për shpirtërat tanë. Shpresa ime ishtë Ati, ndihma ime ishtë [f. 27] Biri, kujdesimi im ishtë Fryma Shëntëruarë. Triadhe e shëntëruarë, qoftë lavduria mbë ty!

Besonj mbë një Perëndi At qi mban të gjitha: qi bëri qiellë edhe dhenë; ato qi duken edhe gjith ato qi s'duken; edhe mbë një Zot Jisus Hristosit, të Bir' e Perëndisë; të vetëmin qi nga Ati i lindur përpara dynjasë; dritë prej drite, perëndi të vërtetë nga perëndia i vërtetë; i lindur e jo i bërë barabar me Atnë, qi prej si të gjitha u bënë; [f. 28] edhe për ne njërezit edhe për tënë shpitim zbriti nga qielli e u trupëzua nga Fryma e Shëntëruarë edhe nga Marin' e virgjirë e u bë njëri, u kryqëzua për ne ndë kohët' Pondiut Pilatit; e pësoi e u vu ndë dhet; edhe u ngrit të tretën ditë, sikundrë thanë shkronjat; e hipi mbë qiell e rri mbë të djathtë të Atit; e përsëri do vinjë me lavduri të gjykonjë të gjallëtë edhe të vdekurit; [f. 29] e mbretëria e ti nuk është të sosur; edhe mbë Frymët të Shëntëruarë, të zotëruarën qi jetë ep; qi nga Ati del bashkë me Prindë edhe me Birë; një të falur edhe një të lavduruarë, sikundrë u fol nga profitë ndë një të shëntëruarë të ashiqarepsur edhe të urdhruarë kishë omollogjis.

Një ishtë pagëzimi për ndiesë' fajevet. Pres të ngritur nga të vdekurit edhe jetë të pasosurë kurrë vërtet, dritë e çelur nga shëntëri e lëvduruarë e të pavdekurit At [f. 30] të qiellit, të shëntëruarit, të lumëzuarit Zoti Hrist. Tuke ardhur mbë të perënduarit' diellit, shohmë dritë të mbremshme. Lavdurojmë At e Bir edhe të Shëntëruarë Frymë, perëndi të kadirçme; mbë çdo kohë të lavdurojmë me zë të lavduruarë, Bir' Perëndisë qi jetë ep, prandaj dynjaja ty të lavduron.

Aksiosna – o Zot! – ndë këtë të shintëruarë ditë pa gjynah, tuke ruatur neve! I bekuarë je – o Zot!; o Perëndia i baballarëvet tënë! – e i mburruarë edhe i lavduruarë [f. 31] emëri yt jet' pas jete vërtet. U bëftë – o Zot! – ndiesa jote mbë ne, sikundrë shpnyemë mbë ty. I bekuarë je, o

Teksti i normalizuar shqip

Zot! Mësomë të drejtat e tua! I bekuarë je, o Zot! Bëmë të menduarë mbë të drejtat e tua! I bekuar je – o [i] Shintëruarë! – e ndritomë mbë të drejtat e tua! O Zot! – ndiesa jote jetë pas jete, punërat e duarvet së tua mos i shtjerë nga sytë, se mbë ty gjan të mburruerit, mbë ty gjan kënga, mbë ty lavduria gjan Prindit edhe Birit [f. 32] edhe së Shintëruarës Frymë; njëment edhe kurdo edhe jetë pas jete vërtet! Njëme[n]t e lësho robnë tënt – o Zot! – pas fjalës sate me hozur! Se e panë sytë e mi leftherinë tënde, sikundrë e bëre të jetë përpara faqes’ gjith hallkut dritë të zbuluarë mbë miletet edhe lavduri mbë hallkun tëndë të krishterin.

Me mustehak ishtë me të vërtetë të të lumëzojmë ty – o Mëmë e Perëndisë! – qi je kurdo e lumëzuarë edhe [f. 33] fort e qiruarë, edhe Mëmë e Perëndisë sënë. Të nderuarënë e angjivet edhe të lavduruarën përmbi gjith angjivet, qi me të paprishur virgjirinë të Perëndisë fjalë lindi të vërtetën Mëmë Perëndie; ty të lavdurojmë!

Forco – o Zoti, Perëndia ynë! – të shintëruarën edhe të drejtën besë të besiturvet’ krishterë bashkë me të shintëruarat kishëra edhe ktë sheher edhe gjith dynjanë jet pas jete!

[f. 34] Çdo frymë le ta lavduronjë Zotnë. Lavduronie Zotnë qi nga qielltë! Lavduronie atë qi përsipërë, se mbë ty gjan kënga, o Perëndi! Lavduronie atë gjith ju angjejt të ti! Lavduronie atë gjith ju fuqit’ të ti! Mbë ty gjan kënga, o Perëndi! Kjo lavduri ishtë mbë gjith shintorët e ti. Lavduronie Perëndinë ndë të shintëruarat e tia! Lavduronie atë mbë të forcuarit’ fuqisë’ ti! [f. 35] Lavduronie atë mbë fuqit e tia! Lavduronie atë nga shumic’ e madhësisë’ ti! Lavdur[onie] atë me zë të borivet! Lavd[uronie] atë me kënga edhe me qemenxhe! Lavd[uronie] atë me dauille edhe me valle! Lavd[uronie] atë me perde edhe me lodrë! Lavd[uronie] atë me tase të zëshme! Lavdu[ronie] at[ë] me tase të folura. Çdo frymë le ta lavduronjë Zotnë. Ngreu o Zoti Perëndi e le të lartësohet dora jote, e mos e haro të varfërin tënt ngjer më të bitisur!

[f. 36] Qanj hallet mbë ty – o Zot! – me gjith zemërën time e të dëftenj gjith çudet e tua. Qoftë lavduria mbë ty qi diftove dritënë e vërtetë e ndritove gjith dynjanë. Qoftë lavduria mbë të lartin Perëndi edhe mbë dhe hozur mbë njerëzit të dashur! Të nderojmë, të lavdurojmë, të falemi,

Kreu IV

të lavdurojmë shuqyrë mbë ty e [të] mbajmë për të matht lavdurinë tënde.

Zoti mbret i qiellit, Perëndi print qi mban gjith dynjanë! O Zot, bir' i vetmë Zoti Hrist edhe e Shintëruarë Frymë! Zoti Perëndi e qengj' i Perëndisë, o Bir' i Prindit [f. 37] qi ngrite gjynahn' e dynjasë! Ndiëna neve, ti qi ngrite gjynahet e d[y]njasë, begenise rixhanë tënë; o Ti, qi rri mbë të djathtë' Prindit! Edhe na ndiej neve, se ti je vetë i shintëruarë, ti je vetë Zot. I larti Hristos! – për lavduri të Perëndisë prindit' vërtet ditë për ditë të lavduronj e ta mburrenj emërin tënt jetë pas jete të pasosur kurrë! Aksiosna [– o Zot! – këtë të shintëruarë ditë të pagjunah na ruaj neve!]

[f. 38] [I bekuarë je – o Zot! – përrindja tënë, edhe i dururarë edhe i lavdëruarë emëri yt jetë pas jete. Amin! Le të bënetë – o Zot! – ndiesia jote mbë neve, sikundrë shpryem mbë ty. I bekuarë je, o Zot! Mësomë drejtësitë të tua! – *tri herë*]

O Zot! – ardëm kurdo bëne mbë ne farë pas fare! E unë thashë – o Zot! – ndiemë e shëroma shpirtin tim se gjynahnë e bëra mbë ty. [f. 39] O Zot! – mbë ty u lëshuashë e mësomë qi të bënj të dashurit tent, se ti je Perëndia im se mbë ty ishtë burim' jetës, nga drita jote shohmë dritë. Hape ndiesën tënde mbë ata qi njohne ty [– Shejti Perëndi, Shejti i gjithpushtetshëm, Shejti i pavdekurë! Ndiëna neve! – *tri herë*] një herë qi angjejt ngadalë thonë e t'i parsojnë edhe asaj qi bën jetë, Triadhës, të tretën shintëri. Këngë e këndojnë edhe na gjith punërat e ksaj jete; [f. 40] t'i lemë kasavete, veç e mbretin' e gjith dynjasë ta presmë me angjejt, pa parë allaj takse ndo bulukë, ndiesë të hozurçme, kurban të mburrierë e me frymë tënde kemi mbë Zotnë; mustehak edhe hak ishtë të falim At e Bir edhe të Shintëruarë Frymë, Triadhë qi ishtë e pandarë.

I shintëruarë [i shintëruarë, i shintëruarë] Zot' i gjith dynjasë! – mbushur qielli edhe dheu nga lavduria jote, [f. 41] sikundrë qi siprë je i bekuarë – o i ardhur me emërit' Zotit! – sikundrë qi siprë je; ty të ndercjmë, ty të lavdurojmë, mbë ty shiqyrë e bëjmë – o Zot! – e të lutemi o Perëndi[u] ynë – o Zot! – qi të Shintëruarën Frymë ndë tre sahate apostojt e dirgove. Ktë – o i Dashur! – mos e hiq edhe nga ne, po përtërina neve me të qi lutemi zemër të qëruarë. Ndirto edhe mbë mua – o Perëndi [f. 42]

Teksti i normalizuar shqip

e [Frymë] e drejtë! – përtëri mbë zemërën time; mos më shtjerë nga faqea jote [edhe frymën tënde të shënjtë] mos e hiq nga unë!

I bekuarë je [o Hrisht, Perëndia ynë!] qi fort të ditur peshkaxhitë diftev' e u dirgove atyre Frymën e Shintë e pre[i] suresh dynjanë e ktheve. O miku i njerëzet; qoftë lavduria mbë ty! Kur zbriti gjuhërat e i derdhi, i [f. 43] ndau miletet i larti Perëndi, për sikur prej zjari gjuhërat i dha mbë një mbë besë, të gjithë[ve] u thiri e me zë: Ta lavdurojmë të Shintëruarën Frymë!

Vërtet i bekuarë – o i ardhur me emërit të Zotit! Perëndia, Zoti' vërtet, u ashiqareps mbë ne për shumë vjet. O Zot! – e pamë dritën e vërtetë e muarmë frymë; nga qiellia gjetmë besë të vërtetë. Të pandarë Triadhë falim, [f. 44] se ajo neve na sosi, na shpitoi për ndiesë gjynahet e për jetë të pasosur. Mbushe gojn tënë me të mburrierat e tua – o Zot! – qi [të] këndojmë lavdurinë tënde, se na aksiose neve të hamë nga të shintëruarat, të pavdekurat e fortë' qëruara punëra. Forcona neve ndë tëndet shintëri gjith ditën, tuke folur të drejtën tënde. Qoftë emëri' Zotit i bekuarë qi njëment e gjer më jetët të pasosur kurrë!

[III: Kronikat beratase]

[A. Pesë kronika beratase të vjetëvet 1764- 1777 – IMQ 172, 173]

- [f. 2] Në vitin 1764, muaji gusht, ditë e martë, u vra Ismail Pashaj në Vlorë.
- Në vitin 1767, më 30 të majit, ditë e mërkurë: Ra një shi i math edhe breshër. Edhe erdhë përrënjtë që nga Hamami edhe nga qoshku i terzinjvet. Edhe shumë mall humbi nga i terzinjvet dhe i papuxhinjvet.
- 1777, korrik 26, ditë e mërkurë: U martua e bija e Kurt Pashajt. Edhe e mori Brahim Beu i Kapllan Pashës nga Vlora. Edhe me koçi e muarnë.
- Edhe u ndërtua ura në Myzeqe.
- Pastaja, më 22 të mujit Gusht, ditën e martë, erdhi ashkëtiu (asketi)

Kreu IV

këtu ndë Kala edhe na dhidhakoi (na dha mësim) tri ditë, të cilin e thoshin Kozma Jeromonahu.

[B. Kronika e Beratit – IMQ 213-247]

[f. 47] Ndë motin e 1785-të, korrik 27, ditë e dielë: Po shkruanj luftënë që bëri Ahmet Pasha Kurti me Mahmud Pashë Shkodrën. Edhe ndë atë ditë lart erdhi asqeri i tija edhe ndënjtj përteja ndë saraet, edhe atje i përmbloodhi, edhe u bënë gjer pesëmbëdhjetë mijë veta. Edhe më katërbëdhjetë ditë të muajit gusht, ditë e ënjte, erdhi ay, Mahmud Pashaj, ndë Gostimë ndërtoi tendat. Edhe frikë mori llauzi [milet]. Edhe sakaqë duallnë rufetërit [shërbëtorët] të gjithë, edhe ndërtuan tendat, aty përteja, ndë ullishtat e Jorgji Maces, edhe sipër ndë Biftë, gjer tek ullishtat që u thonë Karroqe. Edhe e muarnë të tërë qafën, gjer tek fusha që i thonë e Pashajt. Edhe vreshtat ndë Biftë, i hëngërë sa që nukë lanë më. Edhe ndë Gorricë vajtnë dy ditë. Edhe ndë Burdullias vu asqer ndë të tërë atë mëhallë që i thonë Mëhalla e Re. Edhe ndë shtëpitë të Taullah Agait, edhe i bëri ato vise sa që nukë lanë nga të mbiellat, edhe pemët. Edhe nga shtëpirat [f. 48] muarnë plaçkë, çdo gjë që gjetnë. Edhe xberthyen rezera edhe penxherera. Edhe arat me kollomoq i hëngërnë. Edhe prishnë edhe bostanet, ngarkuan qepë. Edhe u vranë mu si qëntë, edhe përteja ndë Velabisht, edhe ashtu bënë, sa kohë që ndënjtnë. Aqë sa edhe vreshtin e Pashajt nuk e lanë. I këtillë zullumi u bë sa që nuk di qysh të shkruanj. Ema i lutemi Perëndisë që të mos bënet herë tjetër. Edhe pasi erdhi ay Shkodërijani ndë Gostimë, edhe i vëllai i tija ndë Lushnjë. Edhe bënë prishje. Doqnë saraet e Haxhi Be Përrenjësit edhe të të vëllat të Pashajt Hasan Be Gurrësi, edhe të tjera shtëpira edhe çifligje. Edhe ky këtu, bëri hendekë, domethënë moterizra, poshtë tek kroji, që i thonë Çezm' e Thatë, gjer tek hendekët ku shkon ujët, edhe zu udhën e madhe. Edhe sicilido ndë vendin e tija bëri moteriz. Edhe të mërkurë, më njëzet e një ditë të gushtit, erdhi edhe pashaj ndë kala, edhe ndënjtj ndë tendët, ndë fushët. Edhe të dielën e pasme erdhi fermi i tija, edhe ay iku që të shtunë së bashku me të vëllanë, se e nxori dhe ky të birin, edhe të tjerë. Edhe ata u ngrenë [f. 49] e vanë në Elbasan. Pastaja muarnë të përpjetën, edhe duallnë gjer në Korçë. Edhe ndër ato vënde ku

Teksti i normalizuar shqip

shkuan, ata që u nxirnin të ngrëna nuk i trazonte, edhe ata që i kundrësuan, i vrau e i prishi. Edhe ndë Grabovë mori qesera. Edhe pasi kondisi ndë Korçë, kishte pashaj atje njerëzit e tija të mbylltur ndë një shtëpi. Bylykbashllarë qenë këta, të parët: Hamza Vlora edhe Dervish Ahmeti, edhe të tjerë, gjer katër qint veta ishin brënda, edhe lëftuan si mundnë, edhe vranë. Pastai i nxuarnë me be, edhe tek duallnë, i zu edhe i vrau bylykbashllarët që zumë ngoje sipër. Edhe ata që u kapnë i rropnë, edhe mbetnë lakuriq. Edhe kështu erdhë aty, pa armë. Edhe në Këlcyrë, tek u kish njerës, i nxori Ali Pashaj, i biri i Veli Pashajt, sepse edhe me këtë ishte i mëritur dhe përandai nukë mundte të vejë më poshtë, veçese ndënji këtu, sepse toskët donin edhe kishin ndërment të na prishnjën, edhe për fill kemi shpëtuar. Edhe ndënji Pashaj këtu ndë Kala, dhjetë ditë, edhe tri ditë ndë fushët. Bëri edhe tri ditë ndë shtëpi të Pa(pa) Gjonit, edhe Ikonomit. [f. 50] Edhe u bënë gjithësej njëzet e dy ditë, që bëri asqeri ndë viset përçark, që është shkruar edhe rufetërit. Pastaja hynë ndë sherrë, edhe toskët. Shkuan pakë ditë dhe mblodhi përsëri Kurt Pashaj, edhe vate ndë Peqint, se kishte atje të mbylltur Kaimakun, ndë Kala me disa njerës. Edhe zu dyfek, edhe mori ca shtëpira. Edhe për fill do t'ë kapte atë shkodranin, po të mos u bërtitnin ca toskë që: "Ikni, se na plakosnë!" Edhe u vranë disa edhe iknë të turpëruar. Edhe Pashaj nukë bëri tri ditë andeja, edhe erdhë aty. Kaqë frikë mori kasabaja, se që nukë munt t'i shkruanj dot një nga një. Ay lëftojti kalanë të Peqinit, aqë sa i çkuli me të mënuar edhe me klithma të gjëmuashme. Edhe rynë disa mesësh, edhe me besa-besë i nxuarnë. Se u ndodhë atje edhe dy të krështerë dyfekçinj, edhe kur erdhë këtu nukë muntnin të tregojnë ato që hoqnë atje brënda, tek u nukë kishin ç'të hanë nga koha e gjatë. [f. 51]

Ndë motin e 1786-të muaji qërshuar: Bënë Barjamin, edhe i biri i Pashajt, Mehmed Beu, çoç ishte qërtuar gruaja e tija me të motrën e tija nga i ati, edhe kish marë Brahim Bejnë nga Vlora, edhe e donte fort Pashaj. Edhe qan e bija përpara t'et, tuke thënë atija: "Ja unë të rri, ja se të ikënj." Edhe Pashaj, me mendjen e tija keqësonet me të birin e tija të vetëm, sesa me të bijën edhe i thotë të iknjë.

Edhe nukë kuxonte kurrëkush t'i thotë që yt atë po thotë që të ikësh prei shtëpie. Vetëm Myhyrdar Agai i thotë. Edhe ay ç'i përgjigjet: "Çapu

Kreu IV

e i thua edhe një herë se, ndë dashtë që të ikën, unë nukë rri.” Edhe përsëri ay dërgoi që t’i prujnë koçira, që të ngrerë plaçkën, edhe nuk po e lënë. Rynë mesësh edhe çoç u taksì. Edhe ndënji për ca ditë. Edhe përsi ngrihet ditën, edhe vete ndë shtëpitë të Kapllan Pashës përsipër Manasgjahut. Edhe një mbrëmje bëri atje, gjer sa hangri darkën. Edhe [f. 52] ngrihet e ikën natën, edhe mer Myzeqenë poshtë me barjak. Edhe u bë i ungji me të, Hasan Beu i vëllai i Pashajt edhe vajtën ndë Frakullë, se ishte i së shoqes. Edhe ngriti babai njerës, edhe vetë ay, vete atje. Edhe ay ikën, edhe vate ndë Peqint. Edhe ngrihet Mahmud Beu nga Kavaia, edhe i mer, i shpie në Shkodrë. Edhe u poqnë me Pashanë. Edhe u ngrënë e erdhë në Peqint, së bashku me Pashanë. Edhe ky kish dërguar për asqer, edhe më njëzet e një ditë të muajit gusht erdhë asqeri i tij. Edhe pasi erdhë asqeri, ay Mahmud Pasha kapi disa atje ndë Peqint edhe i vrau. Edhe kish ndërment të zërë edhe një që e thoshin Kadi, edhe ishte me atë, se ky lëftonte me Kaimakun, i cili që i këtija t’ënit. Edhe me të pikasur që donte t’e zërë, kuvëndoi me të birin e Pashajt, edhe me të ungjin Hasan Benë që kështu-e-kështu do të bënë. U ngrënë me dhunë edhe i thanë atija që: “të na napç njerës, [f. 53] të vemi ne t’e bënë zap Myzeqenë.” Edhe ay u dha. Edhe këta erdhë gjer tek lumi që e thonë Shkumbin. Tek lundëruan u thanë atyre: “Këthehi prapë, se na nuk jemi me atë, po jemi me Kurt Pashanë.” Edhe kur dëgjuan mbi këto këtu të gjithë, edhe i ati i tija, fort shumë u gëzuan. Edhe për pakë ditë erdhë këtu, i biri edhe i vëllai, edhe kadiu i cili kish lëftuar aqë herë. Edhe nuk u tha asgjë, edhe u bënë të tijtë. Edhe kur dëgjoi Mahmud Pashaj iku. Edhe kështu pushuan.

Ndë monë 1786 në muajin e Shëmëhillit: Erthnë ustallarët aty ndë Kala, me të dashurë të Ahmed Pashë Kurtit. Edhe u mbluadhë gjer katër qint e pesëdhjetë veta të vegjël e të mëdhenj. Edhe konakët i bënë këtu, ndë Kalat brënda. Edhe së pari vajtën për këlqere, edhe doqnë kaminëra, atje ku mundnë. Pastaja e punuan Kalanë, edhe e ndërtuan sikundrë është e përtëritnë. Edhe në muajin mars hapi fjalë Pashaj ynë, të paguajmë të prishurat që vanë e prishnë Pashaj, parësia, edhe turqit, edhe ne këtu [f. 54] edhe na shtinë neve këtu gjer dy qesera e gjysmë. Ndë këto ditë të muajit mars, është pakë e pambaruar Kalaja. Edhe turqëria

Teksti i normalizuar shqip

mbluadhë pakogjë aspëra, sepse ka qënë kuvëndi që të japin edhe ata. Edhe më tetëmbëdhjetë ditë të marsit, u tuke gëdhirë e enjte, vdiq Pashaj. Edhe vdekja e tij ka gjaiturë kështu: I shëndoshë, vetëm piu një sherbet nga një heqim. Edhe me të vdekurë ky shpëtuan aspërat që donte të shtjerë. Edhe ditën e prëmtë u kacambitnë brënda ndë saraet, sa që u bë një jamorekujë nga të bërtiturat e burravet edhe të grarisë. Edhe mbyllnë portat, edhe shpëtuan që nukë shtinë dyfek. Pastaja mblidhen rufetërit edhe vanë qahjallarët e rufetravet edhe i pushuan, gjer sa u puthnë të dy, dhëndëri me të birin e tij. Pas pakë ditë, përsëri u kërleshnë, edhe u ngrenë rufetërit edhe u thanë: “Të delni prej saraevet. Edhe i thanë të birt që të dalë, nukë deshi; i thanë të dhëndrit, ay u ngrit me të gjithë njerëzit e vet edhe vaiti ndë Velabisht. Ay atje, ky këtu po mblithnin njerës me olofe [rrogë], aqë sa edhe këtu ndë kalat dërguan nga ana e [f. 55] rufetërvet nga dhjetë veta që t’ë ruajnë. Edhe bënë konakë tri shtëpëra. Edhe më njëzet e dy ditë të prillit, erdhi kapuxhiu prej Stambolli. Edhe kur u gëdhi këjo ditë i puthnë së pari të dy, që t’i japën hesap kapuxhiut për gjënë të Pashait. Edhe mori kapuxhiu aspërat, edhe armë, edhe shumë të tjera gjërëra të vyhera. Edhe passi i mori gjënë, ky mbeti lakuriq. Edhe ay përteja u bë me kapuxhinë, sepse kapuxhiu ra e bëri konak ndë mëhallën Gorricë, edhe agallarët me dhëndërin të gjithë. Edhe passi mbushnë një muaj njerëzit rufetërvet, çoku mori vesh Mehmed Beu që do t’ë japën Kalanë. Më tetë ditë të majit, ditë e shtunë, erdhi Mehmed Beu këtu ndë Kala edhe vu njerës të tijtë, gjer tre qint veta. Edhe përteja ndë Qafët, vu të tjerë. Aqë sa u mbushnë shtëpitë. Edhe ndë kishët përteja vu. Edhe më dhjetë ditë të muajit korrik erdhi asqeri nga Ali Pasha, që kish qënë në Elbasan, gjer një mijë veta dërgoj. Edhe pas dy ditë, tuke gëdhirë ditë e shtunë, turri Mehmed Beu njerës, gjer treqint burra në Gorricë. Edhe vanë e zunë shpellat domethënë shkëmbënjtë. Edhe kishin niet që të marën tendat, edhe topat që i kishte vënë atje ku ishte rrafshë vendi. Edhe bënë dyfek gjer tre sëhat dhe më tepër [f. 56] edhe u vranë, nga këteja dy veta, edhe nga ata ala më. Edhe ndë këtë vent ku ishte asqeri i Ali Pashës, kur dëgjuan që u lëshuan këta që këteja, u ngrenë edhe ata të Burduliasit, edhe kapërcyen lumin, edhe muarnë fushën edhe i ndoqnë, edhe vajtën gjer tek një vijë që është pranë

Kreu IV

sëhatit përteja. Edhe të tjerë kalorës gjer tek ullishtat sipër, edhe të tjerë gjer tek shtëpitë të Durmush Agait, edhe zunë katër veta, edhe u vranë edhe u plagosnë. Edhe harriti që së poshtmi Xhafer Beu, me asqer të shumë, edhe i dëboi i pru gjer tek lumi. Edhe kapërcyen edhe lumin këta. Atje ndënjtë pakë kohë. U vranë, të vdekur gjer pesë veta, edhe të plagosur gjer pesëmbëdhjetë, edhe atje përteja më tepër. Edhe këta, tuke mos diturë se vjen Xhafer Beu, edhe hynë thellë, edhe ndaj të këthyer u vranë. Edhe pastai pushuan. Edhe pasi pushuan pakë ditë, erdhi Rumelia [valiu i Rumelisë] ndë Elbasan, edhe dërgon ay njerës këtu, edhe u thotë: “Të ngrihi, që të dy, të vini, që të vemi ndë Shkodrë.” Edhe Mehmed Beu u ngrit më tridhjetë ditë të muajit qërshuar. Edhe vate e ndënjti katër ditë. Edhe pas një javë vajti edhe Xhafer Beu i vëllai i Ibrahim Beut, edhe gjene erdhi prapë. Edhe si erdhi mblodhi njerës, edhe shkoi ndë Shkodër. Edhe Mehmed Beut i erdhi zëri më 23 të muajit korrik, duke gëdhirë e prëmtë. Edhe bëri donoma [... f. 57-58]²⁷ [f. 59] që duan të na prishnjën. Edhe ay me të çpeitë dërgoi aspërat edhe i pagoi. Pas kohe u këthyen edhe toskët edhe nukë ua dha. Edhe ata iknë edhe u bënë me të edhe si u bënë me të nuk e mbaitnë Morogelepiasin [lagjen “Murat Çelebi”], po i lanë shtëpirat edhe hynë ata. Edhe muarnë plaçkë. Edhe ky ngrihet me fjalën e ulemavet. Edhe plaku vjen ndë Kalat me gjithë fëmijën e tija, me gjënë të tija, me kuajt edhe me mushkat, edhe me asqer, më dymbëdhjetë ditë të Shëmëhillit. Edhe hynë ndë të gjitha shtëpitë, ku pesëdhjetë, ku pesë, ku katër dhe dy. Edhe i ushqyem ne me të ngrëna, edhe për kuajtë dhe për mushkat. Edhe na mbyllnë brënda, sa që nukë kuxonim as të nxierëm gjë dhe as të fusim brënda. Edhe ndë atë kohë ra shi, edhe mbluadhë ujë. Edhe pinë të gjithë ujë. Pastaja u sëmurnë prej ujit. Edhe nxuarnë disa fëmilën [familjen], nxori edhe ay

27 [IMQ – shënim: Faqet 57 e 58 mungojnë, duke qënë të çdukura prej origjinalit, e pra këjo pjesë kronike shqipëtare, berate-elbasane-shkodrane, po mbetet, sot për sot, si fragment që mundet të plotësohet nesër, qoftë me ndonjë kronikë tjetër, të vendit apo të jashtme të cilën nuk e dimë sot, të botuar apo edhe në dorëshkrim të pazbuluar. Fragmenti pason ai i këtillë me faqen 59 të Kondikut K. Berati për t’u mbyllur sindëkur pason:]

Teksti i normalizuar shqip

mushkat, vu njerës që qëruan pusin që është tek Çairi. Edhe natën mornë ujë. Edhe çë të them? Shumë siklet hoqmë nga asqeri.

Edhe më tetëmbëdhjetë ditë të Shënëndreut erdhi një Kapxhi Bash i math [f. 60] edhe me koçi erdhi. Edhe ky qe i Brahim Pashës. Edhe një tjetër Kapxhi erdhi, i cili qe i Mehmed Pashajt. Edhe si erdhë hynë të bëinë huzur. Edhe u melemetisnë dy javë, gjer bënë dashurinë [pajtimin]. Edhe përsi po përhapëshin fjalët, se po vinte kartë që po vjen Ali Pashaj, edhe kish dërguar Islam Be Këlcyrën në fshatin Hrakullë. Edhe vate Haznadar Agai, edhe luftuan sa që e dëboi. Edhe erdhi prapë. Edhe nga ana tjetër pat ardhur Isuf Arapi, edhe Haxhi Dosti, edhe Nebi Zvori prishnë sa fshatëra edhe Gegërinë muarrë shumë gjë. Edhe e ngriti asqerin ay, i dërgoi përsipër tyre. Edhe na thanë që i prishnë. Ema këtu kishin bërë llagën tek Shëndëllin. Edhe më tetëmbëdhjetë ditë të muajit Shënvasil ky zu angari nga ne të kështerët që në mbrëmje, edhe u gëdhinë atje ditën e së kremtes të shënjtorevet baballarë Thanas edhe Qirill. Prenë llagëmin. Ata që e prenë qenë njerës turq e kaurë. Ata e vunë që së poshtmi barutin edhe e prenë vërrimën, ku iknë të gjithë ata që kallnë [f. 61] zjarr, dhe kishin bërë vrimëra shumë, edhe zu tymi të dalë ndë një vrimë, edhe me radhë, edhe të tjerat, kur panë këta, që së sipërmi u larguan pakë nga ay vent, edhe plasi dheri u ngritnë lart së bashku me gurrët, edhe lavduri Perëndisë që nukë pësoi gjë asnjeri nga ata që u ndodhë, edhe kaurët, e çë të them? Atë ditë duallnë mileti i tërë nga çairi edhe bënin sehir, se pandehnin se po gremisej kisha, edhe nukë bëri dëm [...] se edhe përsipër qenë tre veta që nuk u trëmpnë, edhe të thuash aqë sa u tund dheu mu si tërmet mbë të gjitha anët atje edhe këtu ndë Kalat. Pastaja zbrasnë dyfeqet, që shpëtuan. Kur mbushnë dhjetë javë ndë kalat, të prëmtën, dhe duke gëdhirë e shtunë, më njëzet e dy ditë të muajit Shënvasil, vdiq Hasnadar Agaj që ia thoshin emërin Ismail, edhe kishin ryrë mbë pajtim, edhe ryri Seid Qahajaj, edhe Demir Lévani, edhe ditën e Hënë u ngjitnë që së poshtmi edhe që së sipërmi, u poqnë mb'udhë teku janë shtëpitë të Yzeir Dostit, edhe bënë be që të [f. 62] rijë mirë [...] të jemi sipër, edhe kështu bënë be të martën therrnë njëmbëdhjetë deshënj edhe bënë kabuni edhe i poqi i bëri kurban që shpëtoj. Pasi u mbyllnë dhjetë javë ndë Kalat të Ënjten e Madhe

Kreu IV

ngarkuan plaçkën. Pas plaçkës gruaja e tij. Pastaja mbë zëmëreherë i hypi kalit me të gjithë asqerëtë. Edhe shkoj nga evgjitëtë, edhe nga mëhalla e poshtme që i thonë Nalet. Edhe ryri ndë saraet e Dervish Belulit. Edhe të prëmtën u miqësuan ndë Teqenë të Ibrahim Pashajt u qafuan bashkë. Edhe gjene dërguan të dy konakë këtu ndë Kala, nga tre u bënë sicili [...] Edhe në dymbëdhjetë ditë të Shëmëhillit, të Prëmtën, që erdhi këtu, edhe më njëzet e shtatë të Shënvasilit iku, diku vate poshtë. Edhe na i hangri të tëra zahiretë: grurin, verën, vajin, verë, raki, ullinjte, drutë. Tri shtëpi shempnë, edhe kishëra: Shën Gjergjin, Shën Pjetër e Palin, narthikun e Shën Triadhës, Shën e Prëmtën edhe të tjera shtëpira, dy nga mesi dyshemera, vozera. Edhe shumë shtëpira u bënë, edhe plaçkë muarë. Edhe ndë monë 1788 muaji Shënvasil 28, ditën e prëmtë dërguan konakët këtu, gjashtë sikundrë janë shkruajtur sipër [f. 63] të tjera.

Edhe një ditë, domethënë të lindjes së Zonjës Shëmërisë, më tetë ditë të gushtovjeshtës, vajti një djalë, i një Bushliu ndë Budë, edhe kërkon tagji, të mbushnjë torbën. Çoç u zunë, ngrehu një gur edhe e goditi, veshin ia preu, edhe kokën ia shtypi. Edhe gjene një tjetër hysmeçi kërkoi gjellë ndë shtëpit të Janko Shukës, edhe ajo gruaja e Jankos çoç tha. Ngrihet një hyzmeçi edhe i bie me këmbë ndë barkt, edhe bie poshtë. Gjer e ngritnë dhe e shpunë brënda, më nuke ishte gjallë po vdiq, pa kungatë. Edhe na bëmë një arzuhall, e dhamë për konakët, na e çorri. Edhe si u vra gruaja e Jankos, Tankua, gjene bëmë tjetër, edhe ia hothmë. Edhe fort shumë u zëmërua, vetëm i bëri be të padrejtë se ishte e sëmurë, edhe ashtu u përbint.

Edhe më njëmbëdhjetë ditë të gushtovjeshtës, ditë e hënë: U ngjit Xhafer Beu këtu ndë Kala edhe vu konakët qoshe, u bënë të gjitha nëntë. Edhe na tha: "Ju të mbani ujë!", sepse së pari mbanin vetë, me harxhet e tyre, edhe ky e preu. Të tillë të mirë na bëri. Edhe pas jo shumë ditë prapë u nakatosnë. Edhe më gjashtëmbëdhjetë ditë të Shëmitrit, ditë e hënë, hoqnë plaçkën nga dyqanet, sa që nukë lanë asgjë. Edhe duke gëdhirë e martë, pashë një ëndërrë, sikur ura Sërrumbulli ishte gremisurë. Edhe kështu po rrinin sicili ndë konakët që kishtë zënë. Edhe beratllinjte po mundonëshin të ndreqnin punë. Edhe nukë ndreqnë, veçse më tepër [f. 64] po mblidhëshin ndë saraet e Mehmed Pashajt. Edhe

Teksti i normalizuar shqip

ky Xhafer Beu, vu mjeshtëri domethënë ustallarë, edhe ndërtojti tetë konakë, domethënë mbuloi tabjet. Edhe duallnë nga shtëpirat hynë ndë ata konakë që u ndërtuan më parë. Akoma edhe një konak, ndë kalan' e tretë, nuk e kishin zënë ustallarët.

Edhe më njëzet e katër ditë të Shëmëhillit, ditë e VI-të, erth një tahtar i Mehmet Pashajt, që flejti në fshatin Dushar, edhe njerëzit e tija i duallnë përpara që t'e përesën. Edhe (tahtari) ryri më njëzet e shtatë ditë të Shëmëhillit, ditë e hënë. Edhe si erdhi, pas pakë ditë i erdhë ca njerës nga Ali Pashaj, edhe mblodhi akoma asqer. I erdhi një tatar i pru muzhdë për masup, edhe gjene nga Ibrahim Pashaj. Edhe Mehmet Pashaj nukë ndënji po më dy ditë të muajit Shënvasil, ditë e martë, moti 1783 zu luftë edhe luftuan. Edhe të shtunën e pasme, ndaj të gëdhirë, u doqnë dyqanet. Edhe që nga Kalaja hodhi me topat e mëdhenj edhe shumë zabun bëri. Edhe më shtatëmbëdhjetë ditë të Shënvasilit, ditë e Mërkurë, hyri Ibrahim Pashaj. Edhe nga ana e rufetërvet duallnë qolla [përpara] me barjakë, edhe dauille edhe [f. 65] si hyri gjene luftuan, gjer sa e qarkosnë, sa nukë pati ç'të bënë, po iku, ka qënë e prënte mbrëmëherë, pas darke, më nëntëmbëdhjetë ditë të muajit Shënvasil, edhe vajti në Planashtnik. Edhe pasi mbeti Ibrahim Pashaj, ç'bëri? Zu të prishnjë shtëpira, edhe të djegë nga ata që kishin ikur së bashku. Edhe ata që u këthyen edhe ndënjtnë i vu haps edhe i xheremetisi sipas takatit të tyre. Edhe kështu pushoi rrëmulla. Edhe saraet e Myhyrdar Agait i prishi, edhe mori qarramidhet, drurët, dërrasat dollaprat, penxheretë edhe gjithë mbeturinat, edhe i pruri këtu ndë Kalat, edhe ndërtoj hodarat në kalanë të tretë, bëri sternën edhe lëmin e bëri ashtu sikundrë duket gjer më sot.

Edhe në këtë parëverë në muaj të majit më nëntë ditë, domethënë të mërkurë pas dreke, ditën e Shën Kristoforit, dha Perëndia një tërmet që nukë pat rënë herë tjetër ndë këta vënde. Edhe kaqë frikë mori dyniaja, sa që nukë ndënjtnë brënda, po duallë jashtë, jashtë edhe këtu nukë dëmoi aqë po ndër toskët u gremisnë shtëpira u vranë dhe njerës. Edhe bënë kaqë kohë jashtë me çadëre gjer i ndreqnë. [f. 66] Ndë këtë kohë pruri Ibrahim Pashaj misër ndë Kala gjer dyqint barrë, edhe sicila barrë tetë qazera; çdo shtëpi nga dy barrë, edhe nga këjo hangri, edhe shkonte

Kreu IV

buka, gruri katër grosh: edhe misri tre e gjysmë. Edhe këtë parëverë dërgoj njerës në Vockëpojë, edhe lëftuan me njerëzit e Ali Pashajt. Edhe bëri gjithë parëverën asqeri ndë Vockëpojë, edhe vate edhe Xhafer Beu. Po kur erdhi Ali Pashaj mori vesh, edhe ngrihet një natë edhe ikën, edhe e bëri Vockëpojën, edhe rredhet, edhe Oparin. Edhe vrau disa nga ustallarët. Të tërë plaçkën e muarnë, kishëra edhe shtëpira prishnë, edhe njerës rropnë, sa që kurrë ndonjëherë nuk ishte bërë kështu. Hoqnë të zi ata vënde. Edhe atë misrin lart, atje e hëngërë, edhe qesimin edhe izëra shtiu ndë të gjitha fshatërat rrotull, sa që nukë jeti vent që të mos japë. Edhe na hodhi këtu ndë Kala xherreme tri qese aspëra, edhe i dhamë pa bërë fjalë. Kështu e shkuam me Ibrahim Pashën. Edhe Gorrica edhe Mangalemi dhanë [f. 67] moti 1790 edhe ata veçazi, posi ne. Edhe na tha se “Do t’jua zë në harraç; edhe erdhi koha e harraçëvet, gjene mblodhi edhe harraçin emër me emër edhe pa kartë. Edhe pas pakë ditë ra e i vdiq i biri; vetëm atë kish mashkull, edhe fort shumë u hidhëruan, aqë sa prenë nisje-stolirat edhe daullet nukë ranë. Kështu shkoj shumë kohë, edhe gjene vdiq edhe e motra që kish marë Mehmed Pashaj. Edhe e mbuluan ndë taqenë të të vëllatt domethënë të Ibahim Pashajt. Edhe Mehmed Pashaj po rrij tek Toskët atje, si i humbur. Edhe këtu ndë Kala konakët që ishin i la pesë vetëm. Edhe më shtatëmbëdhjetë ditë të Prillit atë natë duke gëdhirë e enjte tetëmbëdhjetë, sëhati më pesë i natës, u errëcua hënëza, domethënë u nxi sa që nukë ndritte bëri dy sëhat. Edhe e panë shumë turq edhe kahurë. Edhe tartarët vijin përditë i thoshin ngreu për sefer. Edhe në muaj të majit u bë pasha Xhafer Beu, i vëllaj i tija. Edhe më njëmbëdhjetë ditë të po atij muaji, ditë e shtunë, doli Ibrahim Pashaj edhe [f. 68] vajti ndë sefer. Edhe më pesëmbëdhjetë ditë të muajit qërshuar doli Mehmed Pashaj te Mali i Bardhë. Edhe lëftuan atje, me ata që qenë mbylltur ndë kullat. Edhe vajtën sipër të jashtërmit, edhe që përbrënda vranë edhe plagosnë gjer dyzet veta. Edhe disa erdhë në shtëpitë të Hoxhës së Zhirovinës. Edhe kur dëgjuan aty kështu, muarë shumë frikë. Edhe ka qënë ditë e shtunë, aqë sa iku pazari, sa që nukë jeti asnjë. Edhe u ngrenë rufetët, vanë në Zhirovinë, edhe nuk i harritnë dot, po iknë. Sepse dëgjuan që u përprish te Mali i Bardhë. Edhe Xhafer Pashaj nuk u ndoth këtu, po ay natën erdhi si iku Mehmet Pashaj.

Teksti i normalizuar shqip

Edhe kështu u bë. Edhe më njëzet e tri ditë të muajit qërshuar, ditë e dielë pas drekëhere, u gremis sëhati i math që ishte ndë pazart, nga Perëndiu. Edhe pastaja u ndërtua atje tek është tani. Një kohë ka qënë kronjëra, edhe përsëri i bëri përpara sëhatit. Edhe u bë më i lartërë nga i pari.

[f. 69] Moti 1769, gusht 19-të, ditë e martë: Zbritnë turqit nga Kalaja, domethënë Byshlinjtë, se i dërgoi fjalë Ibrahim Pashaj të vëllat të tija Xhafer Pashaj, t'i dëbonjën të gjithë, se: (i thosh) "bëmë dashuri me Ali Pashën!" Edhe kështu i nxori. Edhe la vetëm tek Porta e Madhe dy veta. Edhe ndër hodarat brënda la Ymer Marbën me gjithë fëmijën e tija. Edhe kështu u prenë konakët.

Moti 1792, në Maj, ndërtuan ustallarët Saraet që janë përjashta Yç-Kalasë, për zotërin' e tija Ibrahim Pashën. Edhe përbrënda i kish për gratë.

Moti 1793. Ndërtoi Kalanë ndë Biftë në parëverë, me të prishura të veta.

Moti 1794. E hangri lumi gjene pazarin pranë dyqanevet.

Moti 1795, më 2 ditë të muajit Shënvasil, duke gëdhirë e martë, ra dëborë gjer një pëllëmbë edhe ngrijti gjer ndë Ujët të Bekuar, sa që thoshin bota bëri shumë të ftohtë, sa plasnë shtëmbëra edhe bakërëra. Edhe prapë ra dëborë, tri herë u bë këtu ndë Kala. Edhe si u tret, erdhi lumi ditën. Edhe hangri dyqanet që ishin ndaj pazarit. Edhe shumë dëm u bë, edhe ura që e thoshin Ndërmënat. Ndë këtë kohë vu ustallarë të ndërtonjë një mulli, te Vakëfi, Ibrahim Pashaj afërë Manasgjahut. U thanë ullishtëra, fiq dhe të tjera pemë. [f. 70] Pas këto Xhafer Pashaj u bë sebepçi, edhe i tha të vëllat t'e presë resmin, që kish qënë zakon që prej kohe të qëmoçme: Të vdiste një njeri, do t'i paguante së pari Kadiut, sipas takatit kahurë e turq. Edhe na e preu kaftan-pehanë, të mos paguajmë më, as ne as turqit.

Edhe në motin 1796, korrik 5, thërriti Pashaj pesë veta, edhe plaku nga Kalaja edhe nga Gorrice, vajtën atje me frikë përpara tija. Edhe u tha: A e dini se përse ju thirra? Që sot e paskëtaja angarira nukë kini, as për mua as për të tjerë vendës edhe të jashtërmë këtu ndë Berat brënda. Edhe u prenë.

Kreu IV

Edhe në vitin 1797, muaji Shënvasil l. Erdhë krushq nga Ali Pashai, treqint veta. Edhe muarnë të bijën e Ibrahim Pashajt t'ënë. Ditën e enjte erdhë edhe të prëmtën duallnë. Edhe atë ditë llauz i shumë të doli për sehir. Edhe kishin prurë jedikëra shtatë me hehte të bukurë. Edhe me koçi e dërgoi. Edhe prej andeja erdhë me koçi dy gra të mëdha. Në muajin mars i erdhi masup Xhafer Pashajt Igribozi edhe u nis të vejë, edhe nukë la Ali Pashaj, po u këthye prapë.

Edhe në motin 1798 u nis edhe vate tek një, i cili doli pasha i fortë edhe e thoshin Pazanxholl. Edhe me të dashurë të Mbretit vajtën edhe të tjerë shumë pashallarë edhe vezirë.

Edhe më 18 të muajit prill vdiq Xhafer Pashaj atje në Vidin. Edhe të dielën e pasme erdhi haberi i zi këtu, edhe shumë e qarë u bë.

[Fundi dhe lavdi Zotit! – B.D.]²⁸

[IV. "Zonj' e Shën Mëri përpara kryqsë"]

Zonj' e Shën Mëri ardhurë	//	e ndenj përpara kryqsë, [f. 72]
e mbretësh' e engjëjet,	//	zonjë e gjithë dynjasë.
E kur e pa mbërthyerë	//	shpëtimn' e njerizisë
e qante ngashëryerë	//	me mallënjim thërriste:
Judha i mallëkuarë (!)	//	që kallëzoi çifutë.
E erdhë e të rrëmbyenë	//	si uqër të pandiesm.
Të shpunë të të gjykonjëne	//	ndë avlli të Pillatit.
Qiturë shahit jallanxhi	//	që të të turpërojnë.
Të ndyninë e të pshtyninë	//	e të rrah' e të shanë.
Me të math zë thërrisinë	//	ati Pillatit: Vrae!
Vallë ç'u pate bër', o bir (!),	//	a ç'të lig' u punove
që mbë kryq të mbërthyenë	//	e vdekë që të dhanë.

28 Rreshti i fundit: <τε τέλος και το θεω δόξα> bashkë me përkthimin përkatës janë harruar në dsh. e IMQ, (pra edhe te Naçi 1964). IMQ (247) përfundon me shënimin: <(Τέλος των χρονικών του Κωνσταντίνου Ἱερομονάχου). Σημ. Ἑλ. Μ. Κιαφατζέζη Ἐν Κοριτζᾷ, 5 Μαΐου 1943.> : /Fundi i kronikave të Kostë Jeronomakut. II[o] M. Qafëzezi/

Teksti i normalizuar shqip

O biri im i dashuri (!) // e djali im i ëmbli (!)
 Qysh i duron mundimetë, // rrahur' e përçmuarë.
 Duar e këmbë plagosurë // me goshtë të këqia.
 E kurorënë pej drize // që ta vunë mbë krye.
 Me shish brinjënë shpuarë, // derdhurë gjak e ujë.
 Ç'ë kjo gjakësi që bëtë // o çifut' e pabesë (!),
 O të arrënisurit e Zotit (!) // që ai u dha nomnë.
 Që le se s'i besuatë, // po dhe këto ia bëtë
 për të mirat që u pat bërë. // Ngahera u shëronte
 të verbër e të shqepërë, // ulogër e sakatër [f. 73]
 e u ngjallte të vdekurë // t'i shihni të besoni.
 E ju karshi atyreve // vdekjënë i dhatë.
 Mbë të mbërthyerë të ti // dielli u errëcua.
 E hënëza bashkë me të // dhe ajo u helmua.
 Se qysh ai q'i pat bërë, // mbë kryq vdekjë muar
 vetëmë njërezillëku // e jo perëndillëku.
 E dridhësh qiellja e dheu // gurët' u dërrëmuarë.
 E ju qysh s'u menduatë, // bare sa t'i besoni.
 E le ju t'arrënisurë, // se mbetë' të pabesë.
 Po ku ishtë i Shën Pjetri që të tha: // Do të vdes me ty bashkë.
 E t'arrënosi e të la // vetëmë me të tjerët.
 Të gjithë iknë e të lënkënë // ndër duar të të pabeset
 që ata të helmuanë, // kur thirre: Et më vjen.
 Muarrë helm e uthullë // e ta vunë ndë gojë.
 Po ti sikundër ke thën' – o bir! – // si perëndi të ngrihesh,
 të ngjallesh pej të vdekurish, // të shpëtojç njerëzinë;
 ata që të besuanë, // se erdhe u trupëzove
 e u bëre njeri për ta // e gjithë këto i vove.
 Me gjak të shenjteruarë // që për ata e derdhe, [f. 74]
 që t'i shpëtojç pej shejtanit // e përsëri t'i shpiesh
 ndë paradhist e ndë konakt, // tek i vure përpara
 që të të lavduronjënë // ndë jetë të pasosme.

Kreu IV

[V. Fjalësi i vogël greqisht-shqip]

igumen	lundra		
pushtim	bënj zarar	bindem	[f. 75]
bëryli	erë	çartës	
çalëstijë	vozë	vesiet	
bosht	fundos	xhevair	
fajkua	lakësoj	saçma	
i tërë	gjemon	i dyshim	
karkalec	lak	tra	
lyej	plis	metojet	
pluar	gudulis	hark	
qerre	ponica	drapër	
kudhërë	leh	i le	
myti	zhvesh	fil	
i sadoshim	përgjell	i tamëmtë	
rrëmbej	gjerp	gromësinj	
kacek	lëpij	eshk	
	shqas	i zbrazët	
shkrepëtij	tabak	mblidhem	
i ndyrë	pëcëlloj	errësoem	
trap	grusht	squfur	
shtonj	marr vesh	hu	
shkumbë	qerthëllim	garth	
i lik	allçi	bedynisë	
bretëkosë	qoshe	veshje	
balsë[m]	viç	sharra	
shalavriq	darkë	tryelë	

Teksti i përkujdesur shqip

shkas	sipull	[f. 76]
limë	sisek	
troshitur	vedrë	
këlloshkë	capa	
këlloshkë	lëvezhga	
gdhënt		
sdrugat		
kramastare		
prek (= breg)		
përgjell		
sdruk		
garth		
gërjeshtrë		
urdhe		
kurrizi		
qellëza		
njërithi		
kapëzher		
qose		
kthiza		
thembra		
nye		
rrall		
dëndur		
u pajtuashë		
i pajtuamë		

VI. Letra dhe histori apostujsh

[f. 77] I shën Sotirit

O vëllazër! Për këtë punë më tepërë të bëni të vërtetë të ftuaritë tuaj e të zgjedhuritë tuaj, sepse tuke bërë këto do të mos fieni kurrë, sepse me këtë dorë pune do t'u epetë bëgatësisht të hyrëtë ndë të pasosurët mbretëri të Zotit tynë Jisus Hristosit e shpëtimit' shpirtëret tanë. E prandaj nukë dua të përtoni, që të ua kujtonj kurdo këto mirë, se dhe i dini e ini forcuarë mbë këtë të vërtetë. E e mendonj të drejtë unë ngjer sa jam ndë këtë konak të u sqoj e t'u ap juve të kujtuarë, se e di se shpejt do ta le këtë konaknë tim, sikundër edhe Zoti ynë Jisus Hristosi ma ashiqarepsi. E dua të çalëstis të kini edhe ju kurdo e të bëni pasandaj ngëha të ikuritë tim këtë të kujtuarë, se ju s'i dojtë përrallat' e të dituret, po u bëm na juve të njihni fuqinë e konostinë e Zotit tynë Jisus Hristosit, po sikundër e kemi parë me sy' tanë të matht e ti, sepse ai muar nder e lavduri pej Perëndiet e Atit' ti, sikundër i erth kësi dore zëri ngëha e madhea e gjarë lavduri e i tha se ky është Biri im i dashuri që mbë këtë u prejtishë unë. E këtë zë na të gjithë e dëgjuam që erth pej qiellshit, kur qem bashkë me të ndë malt të shejtëruarë e kemi të vërtepsurë fjalënë e profitllëkut, që mbë këtë mirë bëni, se kini mentë tuaj mbë të si lihnar që ndriton mbë vënt të errëtë, gjer sa të ndritonjë dita e ai që mban dritënë të ndritonjë zemëratë tuaj.

Ky apostol është i Shën Sotirit [1767, gusht 23]

[f. 78] E të vdekuret

O vëllazër! Dua të njihni e ta dini për ata që kanë vdekurë që të mos helmohi si ata të tjerëtë që nukë kanë shpresë, as besonjëne, sepse ndë besofshim se Zoti Jisus Hristosi vdiq edhe u ngjall mbë këtë dorë pune, edhe perëndia ata qi vdiqnë ndë mest të besësë' Zotit Krisht do të mbledhë bashkë me të, sepse këtë u themi me fjalët të Zotit, se na të gjallëtë që do të jesëmë do të mos i arinjë më atyre që vdiqnë, sepse ai vetë Zoti me zë të urdhërit' ti do të thërresë engjëlli me shur e me bori të

Teksti i normalizuar shqip

perëndisë, do të zbresë pej qiellshit. Edhe të vdekuritë me Zonë Krisht duanë të ngrihenë më përpara pa pasandaj edhe na që do të jesëmë ndë çast, edhe na me ata gjithë bashkë duamë të rrëmbehemi që të dalëmë përpara Zotit ndë erërat e ashtu do të jemi gjithë jetënë e pasosurë bashkë me Zonë.

[f. 79] Ahere mb' atë kohë vu dorë mbreti Irodhi të vrasë ngëha ata që i kishinë besuarë Zotit e vrau edhe Jakovë të vëllanë e Shënë Ianit me kordhë. E si e pa këtë punë që bëri se ia pëqyenë çifutë', vu ndër ment të zërë edhe të Shën Pjetrinë. E u godit n' ato dit të pashkëve' tyre, andaj e zu edhe e vu ndë zëndan të Shën Pjetrinë e ua dha gjashtëmbëdhjetë sejmenëve ta ruajnë, se e kishte ndër mënt si të shkonjënë pashkët të ua nxjerrë përpara asqerit' çifutet. E i Shën Pjetri ruhish ndë zëndan pej sejmenëshit e apostojtë e tierë i bënë rixha Zotit për të ndë kishët që ta shpëtonjë. E atë natë që më nesëret do ta nxirrte përpara asqerit' çifutet, i Shën Pjetri flinte ndë mest të dy sejmenëve, lidhurë me dy zinxhirë e sejmenëtë ruaninë derën e zëndanit. Mu ndë mest të natësë vjen engjillit' Zotit atje ndë zëndan tek ishte i Shën Pjetri e u ndritua gjithë zëndani. E e shpoi ndë brinjët të Shën Pjetrinë. E e ngriti pej gjumit e i tha: Ngreu me vrap! Edhe ai u ngrit e të lidhuratë e zinxhirët i ranë pej si e u gjent zgjidhurë fare. E i tha engjëlli nvishu e ngjishu e merr rrobet e tua gjithë edhe jakë pas meje. Edhe i Shën Pjetri vate pas engjëllit. E kjo punë i vinte si ëndërrë të Shën Pjetrit e s'e shprente të jetë vërtet ajo që u bë pej engjëllit mbë të. E shkuanë të ruajturit e parë edhe të ruajturit e dyjtë e vanë ngjer mbë portët të hekurtë të kalasë që ajo u hap vetë. E duallë përjashta kalanë e zunë një sokak. Aty më s'e pa engjëllinë se ngëha vate. Ahere si mbet vetëmë i Shën Pjetri, e muar vesh edhe tha njëment: E pashë ashqare, se vërtet Zoti dërgoi engjëllinë e ti e më shpëtoi pej duarshit së Irodhit e ngëha gjithë shpres' e asqerit' çifutet.

[f. 80] O vëllazër! Si fëmijë dritë ta kini të shkuaritë tuaj, sepse hyshuri' Frymësë' Shënjtëruarë është më zhdo mirëcirë e të dreitë e të vërtetë. Hyshuri' Frymit' Shenjtëruarë domethënë janë punërat e mira. E andaj të zgjedhëmë ato si të pëqyera që janë përpara Zotit e të mos përzihe mi ndë punërat të pahyshurçime të errëcirësë, që ato janë gjynahetë. E errëcirë është shejtani që na nangas t'i bënëjmë ato. E na ato

Kreu IV

le t'i kemi të mërzitura e të shanjëmë gjithë ata q'i bënjen' ato, sepse të pshehuratë gjynahe që bënenë likshtë janë. Po pse të flasë njonjë e jo t'i punonjë. Po ato le t'i kemi të mërzitura e le t'i shanjëmë ata që të punonjënë asosh, se gjithë të sharatë punëra pej dritet ashiqarepsenë e dritë është Zoti Krisht. E ai do t'i bënë ashigare ndë kohë të gjyqsë, se çdo e ashigarepsurë punë pej dritet bëhetë ashigare. E andaj thotë i Shën Pavli: Ngreu ti që rri e ngjallu pej të vdekurish e Zoti Krisht do të të ndritonjë, se gjithë gjynahqarëtë si të vdekurë quhenë përpara Perëndisë e ata që braktisinë gjynahetë sikur ngjallenë pej të vdekurish. Andaj me shumë kujdes ta kemi të shkuarë të tanë. Jo si të pamënçim e të paditurë, po si të diturë të harxhonjëmë kohënë e jetësë sanë se ndë këto dit njëmënt shumë bela e të këqia janë. Andaj të mos bëhemi si të pakujdesçim po me shumë kujdes le të zgjedhëmë se cili është urdhëri' Zotit. E të mos ndjekëmë të ngrënë të shumë e të [f. 81] dehemi me verë, se ai është bekrillëk e na shton eshkunë e gjynahevet. Po le t'i lutemi Zotit të na mbushnjë me hir të Frymësë' Shenjtëruarë, të kuvëndonjëmë të psalturatë e nderet e ti e ashtu me të kënduarë shpirtërisht të këndonjëmë e të psalnjëmë zonë ndë zemëra' tona.

O vëllazër! Dua të dini e ta njihni për ata që kanë vdekurë që të mos helmohi si ata të tjerëtë që nukë kanë shpresë as besonjënë. E na ndë besofshim se Zoti Jisus Hristos vdiq edhe u ngjall, ashtu edhe Perëndia të vdekuritë bashkë me Jisus Hristosnë do ti mbledhë, sepse këtë na e themi me fjalë të Zotit, se qysh na të gjallëtë që do të jesëmë, ahëre kur do të vinjë Zoti do të mos u arrinjëmë të vdekuret. Se ai vetë Zoti me isharet të urdhërit' ti do të thërrësë engjëlli e do t'i bjerë shurit e borisë' Perëndisë. E Zoti ahëre do të zbresë pej qiellshit, e të vdekuritë me urdhërit të Zotit Krisht do të ngrihenë më përpara. Pa pasandaj edhe na të gjallëtë që kemi mbeturë bashkë me ta do të na rrëmbenjë urdhëri' Zotit, ndër re të dalëmë përpara Zotit, lart ndë erët të presëmë Zonë, se vjen, e ashtu do të jemi bashkë me Zonë gjithë jetënë e pasosurë.

[f. 82.] Ndër ato dit ahëre çifutëria u qanë mbë të Shën Pavlinë, sepse qirikste Zonë Krisht tek mbreti Agripa. E u përgjegjë ai mbreti Agripa e i tha të Shën Pavlit: Të t'ap testir të më dëftenjësh se ç'u ke bërë këtyre ti që u qanë për ty. Edhe i Shën Pavli u përgjeq e i tha: Unë o mbret Agripa

Teksti i normalizuar shqip

u nisçë me testir të këtyre e me byrdi të upeshkëpinjet e të të kënduarëvet' tyre të vete ndë Dhamasko. E kur vajta ngjer mb'udhë, ishte si mjesëditë, pashë një dritë se ra pej qiellshit përpara meje. E ajo dritë ndritonte më tepërë se drit' e diellit. E e ata se jmenëtë që më kishinë dhënë pas, vetiu këta edhe unë ram të gjithë përmys ngëha frika e asaj drite. E dëgjova zë se më thoshte mua mbë gjuhët çifutërisht: O Saul! O Saul! Pse më dëbon? Likshtë është mbë ty të shkelç ndër gjëmbe. Edhe unë i thashë: Cili je ti Zot? E ai m'u përgjeq e më tha: Unë jam Zoti Krisht, që ti më dëgjon. Po ngreu e qëndro ndër këmbë të tua, sepse unë andaj t'u dukshë. S' dua të të bënj se jmenë tim e shahit mbë ato që pe e mb'ato që dua të të dëftenj, se andaj të zgjodha pej milletëshit' gjithë. E ndër ata njëment përsëri të dërgonj që t'u hapnjësh syt' e tyre e të lënë errëcirënë e të vinjënë mbë dritë, e të lënë hyqminë e shejtanit e të më besojnë për Perëndi të vërtetë. [f. 83] Që të marrënë ndiesë fajevet' tyre e të përzihenë me shejtët, të trashëgonjënë mbretërinë e qiellsë ndë mest të besësë, që të besojnë mbë mua. E andaj o mbëret Agripa pse nukë u bëshë i padëgjuashim i atyre fjalëve që më porositi Zoti po qiriksa përpara ndë Dhamasko. Pa vajta edhe ndë Jerusalem e ndëpër gjithë pshatet të çifutërisë e ndëpër gjithë milletet, sikundër u porosiçë pej Zotit. E qiriksa që të bienë mbë pishmënllëk e të besonjënë Perëndisë e të bënjënë punëra të kadërçime të pishmënllëkut që të fitonjënë mbretërinë e qiellsë.

O vëllazër! Kur erth të mbushurit' e kohësë dërgoi Perëndia të birrë e ti që ky u lint pej Zonjësë' Shën Mëri e u bint fjalëvet' nomit, që të shpëtonjë e të çpërblenjë gjithë ata që ishinë bindurë ndënë fjalët të nomit, që të trashëgonjëmë na të miratë e perëndisë e të quhemi bij Perëndie. E sepse ini bijt' e ti, dërgoi Perëndia Frymën' e të Birt' ti ndër zemërat tuaj që ajo thërret: O print i qiellit! Sakaqë që nukë je më as rop, as hysmeqar, po je bir i ti e një herë që je bir i ti je edhe ndë të mirat të Perëndisë që ato do t'i trashëgonjësh ndëmest të besësë' Zotit Krisht.

[f. 84] O theofile! Unë dua të shkruanj të parënë fjalë për të gjitha ato që nisi Zoti Hristos të bënjë e të dhidhaksnjë gjer mbë atë ditë që vate e u ngjit mbë qiell. Ahere i urdhëroi apostojt' e ti që kishte zgjedhurë ata ndë mest të Frymësë' Shentëruarë, që ndër ta e dëfteu vet'hen e ti të

Kreu IV

gjallë, pas së pësuarësë' ti, dëftyerë shumë nishane e çudi, dyzet dit dukurë ndër ta. E u thoshte e u dëftente ato punërat' e mbretërisë' Perëndisë. E ngëha vininë e gjesdisinë ata, Zoti u dëftehish atyre edhe i porosit[t]e që: Pej Jerusalemit mos ndahi, po të prisni gjer t'u dirgonjë prindi atë që u paçë thënë, që edhe pej meje e kini dëgjuarë se qysh i Shën Jani pagëzoi me ujë. E ju doni të pagëzoni me Frymë të Shentëruarë. E për pak dit u mblodhë apostojtë. Një ditë e pyetn' atë e i thanë: O Zot! Vallë ndë këtë mot do të mbretëronjësh ndë soj të Israilit? E ai u thotë atyre: Nukë është dhënë juve të njihni kohën e vjetë që ata përinti i ka vënë ndë urdhëri' të ti, po si të vinjë Frym' e Shenjtëruarë mbë ju, do të merni fuqi pej si e do të ini shahitët' e mi ndë Jeruzalimt e ndë gjithë çifut' hanët edhe ndë samarit e më të gjith' anët të dheut.

[f. 85] Ndër ato dit ahëre tha i Shën Fjetri mbë asqert që kishin ardhurë të dëgjojnë dhidhaqinë [e] ti: Të bëhi pishman e pagëzohi gjithëkush më emërt' Zotit Krisht! Për ndiesë fajevet tuaj të merni peshqesh Frymën e Shentëruarë që mbë ne ishtë dhënë, që pej nesh ta merrn[i] edhe ju e ta epni mbë gjithë fëmin' e tuaj e atyre që të besojnë ndë mes' tuaj Zotit Krisht, Perëndiut tynë! Me këso fjalash i postomosi e u streksënë e bësuanë Zotit si nja tri mijë shpyrt e rrinin e e dëgjoninë dhidhahinë [e] apostoet, kishinë shumë evlavi mbë nishanet e mbë çudit që bënë apostoitë përpara.

[f. 86] Ndratoi hiri yt, o Zot! Ndratoi të ndrituritë e shpirtëre' tanë një koe e begënisurë, një koe e pishmënllëkut. Të braktisimë punërat [e] errësirësë e të ngjeshnjëmë armët e dritësë e të shtrinjëmë thellësirën' e madhe të agjërimit e mbë të tredicimit të ngjëriturë të i arrinjimë të dalnjëmë të Zotit, shpëtimit tynë Jisus Hristosit që na shpitoi shpirtëret të tanë. O i lavdëruarë ndë kujtime të shejtëvet t' tu! Hrishti Perëndi! – që pej syrish i luturë, të na dërgonsh të madhenë ndiesë!

Poçe lugë mezi të rjep
me gaxhi të mbluam shkas

VI. Fjalësi i madh greqisht-shqip

ergje[n]t	e patrubullë	veshti	f. 87
tjetër	avllia	e tërë	
lule	anë	të liga	
i shtrejntë	kripa	vjen	
pa voli	e vërtetë	paqepur	
shtrejnt	[ndë..ti]	shejntë	
të vërteta	burrë	engjëll	
lere (!)	lart	gjynah	
lemë	ngjitu (!)	nisa	
yll	prëhu (!)	nis	
nis	dëgjo (!)	nisinë	
mënon	dëgjova	të nisurë	
mënojnë	dëgjon	vea	
mënova	dëgjonë	vetë	
mënohenë	e pamarrëburrë / e [pamar]tua[rë]	dua	
	haronj	do ti	
	harojnë	do ai	
dyqan	haron ti	duanë	
i panginjurë	haron ai	Ohërit	
i pangriturë	haroi	praptazi	
paskëtaj	yje	miell	
nesër	njeriu	i panderçim	
adhiqi	hape (!)	kali	
e bardhë	hap unë	kuaj	
ara	hapinë	kopra	
t'ëgra	hapetë	çakalli	
era	e pagjarë	zimbilea	
gumpire	e pakacaturë	merimaga	
kaposhi	le të jetë	mjegulla	
i paditurë	le të bëhetë	i njomë	
i pakënduarë	le të vinjë	shtonj	

Kreu IV

rreze	le të bënjë	shtojnë	
mashkull	le të thotë	shto [!]	
pëqen	e ligë		
[për ka..]	sjetulla		
	paterica		
shtoni	qelbetë	mbrëmë	f. 88
të shtuarë	qelbësirë	mundim	
vëlla	papunku	kualletë	
motrë	bregu	kuallem	
po [= por]	manushaqe	kuallenë	
dëgjon ti	drishta	gjalpë	
dëgjonj unë	nenë	buallica	
dhelpera	kolla	buaj	
krastaveci	kualletë	bën keq	
i vërtetë	qufrë	zien	
e vërtetë	vërtet	zienjë	
e lë unë	tërshëra	ziejnë	
e lë ti	kullot	bie shi	
e lënë	buron	shiu	
andej	mbretëria	shtrengim	
këtej	mbreti	shtrengohem	
ndryshe	vë unë	mundime	
pej haramis	nxirr [!]	ndih	
tjatër	sisë	ndihmë	
këlqere	ferra	ndihmë	
prilli	nxjerr	ndih unë	
gushti	çesma	voza	
pa ngrënë	gjenj	sheh	
pa pushuarë	gjejnë	delli	
ti vetë	gjindetë	shohënë	
pambuluarë	gjeta	shoh unë	
të shtrejtë	kartë	sheh ti	
mënoi	buali	kur vë	
rrezea	buallicë	mundojnë	

Teksti i normalizuar shqip

grep	kau	mundonjë	
mënove	myhyrdis	dual	
	gjëmim	dola	
	peci	dole	
	jodhima	dualë	
	thellë		
	të thellë		
pagëztoj	shkruan	lëpin	f. 89
pagëzim	shkruaj unë	lëpijnë	
pagëzojnë	shkruajnë	gomari	
kullosënë	shkruaj ti [!]	mavi	
e lagurë	grua	e ëmblë	
bar heqimi	gra	shpejt	
bozilok	pilletë	marr vesh	
pagëzohetë	lindetë	mbush	
gjeraqina	kthehem	mbushin[ë]	
bën tahmin	kthen ti	mbushe	
bënj tahmin	kthehe	mbushurë	
tahmin	kthejnë	dhëndër	
pagëzon	kthehenë	qesh ti	
e liga	i shëndoshë	qesh unë	
nxirri [!]	të shëndoshë	qeshinë	
Bagdati	drithë	qeshimë	
rëndë	të kthjelltë	qeshni	
të rëndë	u kthjellti	të qeshurë	
[e panderitur]	qumështë	mendja	
[u nderis]	kosi	njihe [!]	
blenë	bulçi	e njohurë	
gjilpëra	mjekra	njoh	
bleva	mustaqetë	njuh	
bleve	shkruhetë	njuhënë	
blenë	lopa	gjunjëte	
blemë	mace	gjuri	
bletë	gjuha	devea	

Kreu IV

lëshoe [!]	lëpij	derri	
e gjuçime	lëpin	e lëshonj	f. 90
lidhe [!]	huajnë	zgjedh unë	
munt	huani ju	zgjedhënë	
stagonë	huajmë	zgjedhëmë	
dy	huan ti	zgjidhnë	
epe [!]	huan ai	për mua	
ep	pisha	për ty	
për tjatër	rrjetë	për ne	
kumbulla	iqindia	për ju	
kapsho [!]	fajde	për tynë	
dhëmbi	gjithë farësh	për mua	
dhëmballë	fuqi	për ata	
punoj	apënë	për ato	
punon	hak	dhjetë	
punon ti	dëften	dymbëdhjetë	
punojnë ata	dëftejnë	dhaskali	
punoni ju	dëfteni	të dhëna	
punonjëmë na	dëftejmë	lisi	
punës	imea	gjishtja	
rop	jotea	e lidhurë	
gjisht	jona	e zgjedhurë	
gjishtër	juaja	zgjith	
mihuri	e tia	zgjeth unë	
ep	kapshonj	zgjeth ti	
rrah	kapshon	zgjedhënë	
rreh ti	kashon ai	nukë dua	
rrahënë	kapshoninë	sepse	
rreh ai	kapshoni	dafina	
të rrahurë	kapshojmë	fort	
rrahëmë	e tyrea	mbleth	
rrihnë	apimë	mblith	
rrahënë	epni	e mbledhurë	
	zgjedh ti	mblidhni	

Teksti i normalizuar shqip

shkopi	Shën Nëkolli	mbleth ti	
huaj		mbleth ai	
huanj		mbledhinë	
bëra	thoshë	dhe ti	f. 91
bëre	hazër	dhatë	
bënë	shty	e mbultë	
bëmë	shtyra	e mbula	
bëtë	shtym	e mbule	
fjeva	shtytë	e mbulmë	
fjeve	vura	përsëri	
fjenë	vure	nëntë	
e mbulëm	vunë	e shita	
një	vumë	e shite	
është	vutë	e shit[t]ë	
jam	nxore	e shitm	
je	nxuarë	shtyre	
ishnja	nxora	punara	
ishnje	nxuartë	punë	
ishte	nxuarm	ky	
jotea	atje	çava	
imea	ai	çave	
juaja	ata	çanë	
jona	u nisë	çatë	
difteve	u nismë	çam	
dëfteva	u nisë	qava	
diftyetë	u nisçë	qave	
diftyem	shtypa	u ftoh	
diftyenë	shtyptë	u ftohçë	
kushëri	shtype	u ftohe	
dogje	shtypmë	u lothçë	
dogja	hymë	u lodhe	
dymose	hytë	u lodhë	
dymosa	hyra	u lothm	
dymosnë	hyre	u lohtë	

Kreu IV

the	e dham	shtrëngova	
	dhashë	shtrëngove	
shtrënguam	e shikove	dëgjova	f. 92
shtrënguatë	e shikuam	dëgjoi	
u mveshtë	e shikuatë	digjuam	
u mveshe	ika	dëgjuatë	
u mveshnë	ike	u rrahçë	
u mveshm	ikmë	u rrahe	
u mveshtë	iktë	u rrahm	
ti	shprenj	u rrahtë	
unë	shpren	kisha	
ty	shprejmë	dha	
mua	shpreni	java	
e ngrite	shprejnë	vola	
e ngrita	shpëtonj	vole	
e ngritim	shpëtova	e folë	
e ngrititë	u shpëtuashë	milet	
këtu	shpëtuanë	ullinj	
përzjeve	shpëtove	njëmbëdhjetë	
përzjeva	shpëtuatë	njëqint	
përzjem	shpëtuanë	nxora	
përzjetë	drëri	gjashtëdhjetë	
e vrave	e tartise	shtatëdhjetë	
e vrava	e tartisa	nëntëdhjetë	
e vram	e tartismë	u mbut	
e vratë	e tartistë	u rruashë	
e hoqa	thashë	u rove	
e hoqe	the	u rruanë	
e hoqmë	tham	u rruamë	
e hoqtë	thatë	kërpudha	
u zahmetise	themi	tunde	
u zahmetisçë			
u zahmetism			
u zahmetisti			

Teksti i normalizuar shqip

e shikova			
zili	të kërkuarë	desha	f. 93
zileps unë	të kërkuara	deshe	
zileps ti	rron	deshnë	
zilepsinë	rronj	neqesllëku	
zarar	kërkojnë	magrurllëku	
jeta	kapruall	shpreva	
brezi	mbrunj unë	përtesa	
breza	brun ti	kujdesi	
lëngu	mbrunjëmë	agjërimi	
brumi	mbruni	të dashuritë	
vilani	i marrë	të paratë	
kërkonjë	mbrun ai	besa	
kërkon ti	mbrujnë ata	qërshori	
kërko	kaprolle	korriku	
i gjallë	e derdhi	kolozhegu	
të qasurë	e derdha	njëzet	
u qase	e derdhënë	prunë	
kandari	e derdh	prura	
tartise	e derdh ti	prure	
të gjallë	e derdhni	erdhe	
kërkojmë	e derdhimë	arçë	
kërkoni	sharra	erdhë	
zilepsëni	e derdhe	e kjo	
zilepsimë	të zë	e shejtorea	
sheqeri	të zësh	e jeta	
rrojmë	të zënë	gjurmë	
rroni	të zëmë	ta tunt	
rrojnë	tunde	tundenë	
perëndia	ethetë	mirë	f. 94
çuditem	i trubull	i mirë	
çuditenë	çudite	m'i mirë	
kalli	çuditenë	i lik	
këllas	çuditetë	e liga	

Kreu IV

k[ë]llisni	bija	kallëmi	
zemëronj	mbesa	zemëra	
zemërohem	ungji	krye	
dua	vdekja	zelvia	
duanë	shpresë	kopshtë	
do	shprejnë	zoti	
kasavet	të kallurë	shtjerna [!]	
deshmë	kurban	qeramidhe	
zemërohe	do	digje	
zemërohetë	ngashërim	digjetë	
zemërohenë	zemëruarë	digjenë	
mili	zemëratë	të djegurë	
perëndinë	thimjatoa	dymi	
perëndisë	kënjemi	dym, xirë	
e surtuarë	perëndilemë	kështenja	
surton	thëthin	e mirë	
surtonj	thëthij	fusha	
surtojnë	thëthijnë	e qiruarë	
të kallurë	thëthini	qirohem	
surtohenë	thëthinjëmë	qirohetë	
surtohetë	dera	përposh	
shpren	parathiri	okllai	
shprej	deti	kusia	
shpren ti	froni	fëngjill	
shprejmë	urdhër	fëngjij	
shpreni	urdhëri yt	kiza	
ashtaha		zambaku	
ashtahatë		fli [!]	
femërë		vapë	
		bëj [!]	
		bënj	
		qyqe	
		elbi	
bënjënë	mbërthejmë	sikund[ë]r	f. 95

Teksti i normalizuar shqip

bëni	sorra	koha
rri ti	ftohe [!]	xheç dua
rri unë	i ftohëtë	shtjerna [!]
kala	ftohëtë	i mvarurë
skërbonjë	qaj	mviretë
bathë	qan ti	kur bën
pasqyra	qajnë	kalcina
minot	qajmë	njonjë
thumba	qani	kushdo
i shkurtërë	vjeth	të mirë
kërcuri	vjeth unë	site [!]
këmbora	vjedhënë	sit
kungull	vjedhëmë	sitinë
gjuan	qani	sitni
kërpi	qan	sitimë
sita	e vjedhurë	sit ti
shosha	pshehurë	vetëmë
zbrit [!]	mbërthenetë	kaluar
kokale	vera	hipën kaluar
i lumë	mish	hipinj kaluar
rrinë	shtësë	hipinë kaluar
bënjëmë	e ngrehurë	hipimë kaluar
bëni	ardhi	hipini kaluar
goshta	ardhitë	qilia
goshtë	kyçi	gjynah
mbërthyerë	këçyturë	koshi
qepa	këçyte [!]	kosturi
keçe	gjyq	e prerë
kurora	i shqepërë	preje [!]
mbërthenj	gjemi	pres
mbërtheva	kedhi	pret
	përdita	pritenë
	përmbërëma	pritetë
		presim

Kreu IV

kolas	vaj	tamahu	f. 96
prita	ndrit	lihnari	
pres	baltë	soropuç	
presënë	qafa	mesha	
pritni	lulea	li[r]i	
presëmë	ujku	lajthi	
prita	soropuç	çair	
pret	zgjidhe [!]	rripi	
dega	të shkoqura	rripa	
arëvet	e shkoqurë	thëllëza	
vështronj	them	trari	
vështrojnë	thua	viçi	
vështron ti	thotë	vetëmë	
vështro [!]	thonë	muaj	
vështron ai	themi	mollë	
mbani	thohenë	mulliri	
mban ti	ku thua	dita	
mbanj	aslani	hise	
mbajmë	mendim	flokëtë	
mba [!]	hesap	lesh	
mbajnë	fjalë	vetullatë	
parmak	merr	mushka	
lëfton ai	i lohiturë	e gjatë	
lëf[t]onj	i lathiturë	i gjatë	
lëftonjëmë	hendek	hunda	
lëfton	harami	syri	
lëftoni	hamëm	sytë	
lëftova	uqër	më dirgoi	
gjurmë	zgjidhimë	më dërgove	
ridhani	zgjidhni	më dërguanë	
jungari	asqer	më dirguatë	
	lepur	më the	
	gjol	më thanë	
	lahem	e zezë	

Teksti i normalizuar shqip

	lahe	shahit	
	lahenë		
të thuash	të marr	çjerrëmë	f. 97
të them	të marrësh	çirni	
të thoni	të marrënë	e çjerrë	
të bënjsh	të merrni	volla	
të bënj	marrënë	vuallmë	
natë	dremit unë	vualltë	
të pëlcaç	dremit ti	i squarë	
të pjek	dremitni	sqonjëmë	
nip	dremitimë	sqoni	
mbesa	dremit ai	dhallëtë	
laj	dremitinë	brisku	
lan	i shënëdreu	rruhem	
lahenë	drutë	rruaj	
lahem	drua	rruajmë	
agjërimi	di ti	dinë	
agjëronj	di unë	di	
agjërojnë	e thatë	dimë	
agjëronjëmë	dhjamë	dini	
agjëroni	uthulla	u gdhi	
foshnjë	ville [!]	kushiri	
foshnjatë	të vjellë	kushiriri	
ej	e drujtë	rru[h]jeni	
ujë	sqoj unë	rruhemi	
i vdekurë	sqon ti	rruhe	
të vdekurë	sqojnë	daulle	
thonjtë	e tharëtë	zurna	
të kuvëndonjëmë	çirre [!]	bori	
ujra	çjerr		
të viç	çjerrënë		
të vinj			
të vijnë			
të vini			

Kreu IV

të vinjëmë			
të gjithë	at	pyet	f. 98
të gjitha	pësonj	pyes	
pak	pëson	pyesënë	
si	pësonjëmë	pyesëmë	
sa	pësoni	pyetni	
që	pësojnë	pyet ai	
shpejt	guri	vadite	
gjithë	vajta	vaditurë	
i përtesçim	vajte	<u>rri</u> ka	
përtesa	vamë	qep	
kur	vanë	qep ti	
kush	burim	qepinë	
tetë	besa	qepimë	
jashtë	besonj	qepni	
dërejt	beson	shega	
të varfërë	besojmë	penjë	
bea	e hidhurë	rrogë	
be	lakrori	shtjerë	
kush ka frikë	pëlurë	shkopi	
groshë	pashkëtë	shkopinj	
prapa	grasht	shtjere [!]	
shënmitri	kurvar	shtini	
akëkush	dhemp	shtjemë	
tetëdhjetë	këmba	qiqëra	
qarpëri	lumi	oris	
qërpinj	gongalea	rumi	
kur ta kënda	pesëdhjetë	gërqisht	
syri	lumi	shtie	
të gjitha	pusi	qep ai	
male	çismetë	qepimë	
sëhati	plagë	qypi	
pula	qysh		
	të dhimturë		

Teksti i normalizuar shqip

	sa		
	kur		
	përsëri		
	shkel		
vjeshta	shuaje	fëmijë	f. 99
sot	shuarë	muri	
ecë [!]	mbulesë	e kuja është	
ngrie [!]	pshesa	vënt	
ngreu [!]	pshije	fajda	
ngrihi [!]	shkalloj	mbështille [!]	
ngrihemi	shkallojnë	i sajtuarë	
fik	krahërori	gjëkafshë	
mjaft	pajtoje [!]	tridhjetë	
dërasa	enë	tri	
dërasatë	robinja	katërë	
tamëm	rop	toçilë	
bëj seir	pika	djathë	
bënjë seir	shtëpi	dashi	
bëjnë seir	rrush	cjapi	
bënjëmë seir	hirrë	kësosh	
bëni seir	shtëmba	vallë	
bën seir	fron	varri	
hekuri	udha	i nderçim	
shkalla	shati	flokëtë	
qeni	sejmen	hiq	
bushtra	shtrembërë	tridhjetë	
vraje [!]	e ngushtë	burnot	
errëcira	zjari	e prura	
vent i errëtë	e shtruara	e prure	
kordha	rrëmo [!]	i sajtuarë	
zakon	koqe	vrime	
helli	dërgo [!]	të mëdha	
ngjat	dirgoe [!]	shpoje	
thesi	ther [!]	shpuarë	

Kreu IV

thasëtë	there [!]		
dyzet			
feloni' upeshkëpit			
shkurti	fëmijë	tatëpjetë	f. 100
dritë	hamë	dimëri	
furra	ha unë	buzëtë	
ruhu [!]	ha ti	dora	
mik	hani	ngjala	
bjere [!]	hamë	dallandyshe	
të mbjella	bjërë [!]	gëzim	
mbill [!]	bjemë	karta	
ëjturë	bini	gëzou	
ashiqare	feneri	iktiza	
lopata	firauni	borçë	
duketë	robotë	kam borç	
vesetë	thirri	ke borç	
fisi	thirres	kanë borç	
miqësia	thirresënë	kini borç	
puthe [!]	thërresëmë	kemi borç	
thjerëzë	thërrisni	pata	
ndërton	fryj [!]	ar	
mjaft	fryn	krëhëri	
puthemi	frynj	krëhërë	
ruaje [!]	frynë	ara	
zëndani	fryni	aratë	
ikimë	fryjmë	e njomë	
ikënj	fryje [!]	bari	
ikinë	hunj	ari	
ikë [!]	gjemenxhe	hinka	
		hiri	
		prisha	
		prishurë	
		bërëshëri	

Teksti i normalizuar shqip

gëshërë	pishk	u zëmëruashë	f. 101
bukë	tundet	të zbutesh	
shpyrt	breshëri	unjë t[i]	
lart	dëbora	trastë	
i lartë	vesa	pemë	
pleshta	brymët	shtypurë	
morra	mali	të ndanj	
thërime	fusha	të shtynj	
rogozi	pylli	e psheu	
gënjeshtrë	barëzat	buzë	
gënjeshtra	preshtë	peshem	
gënjën	udhratë	miu	
gënjëj	trëndafilëtë	shehit	
gënjën ti	mall	plepi	
gënjejnë	gunë	madhe	
gënjëni	hejbe	të nëmëroj	
gënjejmë	lëshoje [!]	qepër	
mvish	ndien	shtogu	
gënjeva	piqenë	dolloma	
gënjeve	shefteli	vij [uji]	
pjekurë	plehë	lëkur[ë]	
piqe [!]	zerdeli	ndërtova	
pjek	të mbleth	i ndyrë	
psal	lidhe	penjtar	
peshk	mësallë	të thyenj	
peshkaxhi	mulli	të çanj	
peshkaxhitë	të bluanj	të grinj	
z[gj]ebeja	thasë	të biesh	
shati	pushoni	e re	
	nisetë	opinka	
	shkonj	u stolis	
	shportë	të mvishem	
	rrëmih	të shvishem	
qese	u lodhçë	pulpa	f. 102

Kreu IV

kuletë	vatra	më luaj
dimëri	bie erë	kofshët
të mbath	[thonjëtë] mëngët	supet
të zbath	të pështetem	shpatullat
të ther	të ngjynj	barku
më leve	ndënë hie	zorrëtë
çalonj	bari	milçija
arnonj	ki shëndet	be
të shponj	sharqinj	bast
të ngjesh	pjepre	mjel
më tunt	koqe	të vjel
m' u ngarkua	thjerzë	të shku[n]t
me pahir	qiqëra	fjeva
të shkolit	arë	të munt
më shpëtoi	lajthi	të jarënj
të ngjit	elp	të tret
të shqit	mënazë	simvjet
të pëshihemi	kullos	dronj
qyqe	dhentë	që vjet
bilbili	gjemba	anë
sorra	thellësirë	këmborë
breshka	e përpyetme	pipeq
të sjellë	e tatëpyetme	të krip
terzi	ndënë hie	husmet
të qas	e liga	tru
të dëbonj	stan	vrer
ura	këmbë	kalbët
rritet	ta farkonj	hell
u tëholl	më [.....]	inat
mbeçë	duron	paskëndaj
sëmurë		të ushqenj
u shërua		endërë
		rogën
		qiranë

VII. Miscellanea

[f. 103] Ksomollojisi me Zonë, se i mirë – al`li se jeta! Ksomollojisi me Perëndinë e perëndivet – al`li se jeta! Ksomollojisi me Zonë e zotëret – al`li se jeta! Që bëri çudi të mëdha të vetëma – al`li se jeta! Që bëri qielltë me të diturë të ti – al`li se jeta! Që forcoi dhenë mbi ujrat – al`li se jeta! Që bëri dritëra të mëdha të vetëma – al`li se jeta! Diellinë mbë hyqmit të ditësë – al`li se jeta! Hënëzënë e yjetë mbë hyqmit të natësë – al`li se jeta! Që prishi Misirrë me të lindurat të para të ti – al`li se jeta! E nxuar Israilë pej mezit së ti – al`li se jeta! Me dorë të fortë të fuqisë' lartë të ti – al`li se jeta! Që hapi Den' e Erithrajt mbë dy udhëra – al`li se jeta! E shtirti israilë ndëpërme[s]t të ti – al`li se jeta! E mbyti firaunë me gjithë asqer` të ti ndë Det të Erithrajt – al`li se jeta! E mbloth asqer' e ti ndë shkretëtirët – al`li se jeta! E prishi mbretër të mëdhenj – al`li se jeta! E vrau mbretër të fortë – al`li se jeta! Sion mbrenë të amoreëvet – al`li se jeta! [f. 104] E Oh mbrenë të Vasavit – al`li se jeta! E u dha dhen e tyre trashëgim – al`li se jeta! Të trashëgojnë Israili asqer' i ti – al`li se jeta! Se mbë të tapinosurit tënë na kujtoi neve Zoti – al`li se jeta! E na shpëtoi neve pej armikut tynë – al`li se jeta! Ai qi ep ushqimnë çdo njeriu – al`li se jeta! Ksomollojisi me Perëndinë e qiellët – al`li se jeta!

Perëndilemea shpresë e gjithë të kështerëvet! Mbulo e ruaj e shpëto ata që shprenjënë mbë ty!

Perëndilemea shpresë e gjithë të kështerëvet! Mbulo e ruaj e shpëto ata që të shprenjënë mbë ty!


[f. 105] Nderoni emëritë' Zotit! Nderonie rop Zonë! Ju që rrini ndë shtëpit të Zotit, ndë avllit e ndë shtëpit të Perëndiut tynë, nderoni Zonë, se i mirë Zoti. Psalnie emëritë' ti, se i mirë. Se Jakovë e zgjoth për vet`he të ti Zoti e Israilë që të përzihetë me të. Se unë e njoha, se i madh Zoti e Zoti ynë mbi gjithë perëndit. Gjithë sa desh Zoti, i bëri mbë qiell e mbë dhe, ndëpër detet e n[d]jëpër gjithë thellëcirat, ngriti retë pej fundit së dheut, shkrepëtimë e shi bashkë mbë r[e]. Ai nxuar erëtë pej hazinesë' ti, që prishi të lindurat e para të Misirit, që më njerëzit e gjer më shtësët,

Kreu IV

e dërgoi nishane e çudi ndë mest tënt – o Misir! Firaunit e mbë gjithë ropt të ti, që prishi shumë milete e vrau mbretër të fortë, Sion mbrenë të amoroëvet e Oh mbrenë të Vasavit e gjithë mbretërit e Hanaanit e u dha dhen' e tyre trashëgim, ta trashëgonjë Israili asqerí' ti. Zot! – emëri yt gjithë jetënë e të kujtuaritë tat është soj pas soj, se gjykon Zoti asqerr e ti e mbë rop të ti mallënjehetë idholatë e miletevet, ar e sërma punërat e duaret' njerëzet. [f. 106] Gojë kishinë e s'kuvëndoninë, sy kishinë e s'shihinë, veshë kishinë e s'dëgjoninë, sepse s'ishte frymë ndë goja të tyre. Ashtu u bëshinë ata që i bënë ato e të gjithë ata që shpreninë mbë to! Shtëpi e Israilit, nderoni Zonë! Shtëpi e Aaronit, nderoni Zonë! Shtëpi e levitëvet, nderoni Zonë! Ju të frikshimit e Zotit, nderoni Zonë! I nderuarë Zoti pej kishet që është ndë Jerusalim! Lavdi e Atit e e Birit e e Shentit Frymë! Njëmënt e gjithë jetën' e jetësë, amin! Alil'luja! Lavdia jote, – o Perëndi!


[alfabeti original]

[radha e parë]




ar ver ban gjegjem dhe do e za ime thon jote ju je ja

[radha e dytë]



jo kam lule ment na njo ksi o pe rent sy tete ë fe

[radha e tretë]



u çe hir pse sheh shto ca çaju oi math